



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.02.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Jorida Tabaku – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi nga komisioni i dokumentacionit lidhur me impiantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Tiranës.
2. Vizitë tek impianti i trajtimit të mbetjeve urbane të Tiranës.

Marrin pjesë:

Jorida Tabaku, Ermonela Valikaj (Felaj), Antoneta Dhima, Anila Denaj, Arben Pëllumbi, Fadil Nasufi, Besion Ajazi, Eduard Shalsi, Edmond Spaho, Belind Këlliçi, Luçiano Boçi, Helidon Bushati, Ina Zhupa dhe Denis Deliu.

Mungojnë:

Etjen Xhafaj, Lefter Gështenja dhe Dhurata Tyli (Çupi).

HAPET MBLEDHJA

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë,

Ftojme përfaqësuesit e medias dhe kush është i interesuar.

Ju kërkojmë ndjesë për fillimin pak më vonë të mbledhjes!

Sot komisioni hetimor i inceneratorëve bën prezantimin e fundit të dosjes së inceneratorit të Tiranës.

Sot në rendin e ditës kemi prezantimin e inceneratorit dhe një vizitë tek impianti i trajtimit të mbetjeve urbane të Tiranës.

Para se të fillojmë mbledhjen, zoti Lefter Gështenja, i cili nuk është sot këtu më ka kërkuar disa herë që të bëjmë një kërkesë për shtyrjen e komisionit hetimor. Thotë që unë dua të njoftojë medien që në datën 20.12.2021, në cilësinë e kryetares së komisionit, i kam bërë një kërkesë Kryetares së Kuvendit për shtyrjen e këtij komisioni. Këtë kërkesë ne e diskutuam shkurtimisht në mbledhjen e datës 19 janar dhe nuk kemi vullnetin politik të palëve. Megjithëse kërkesa jonë është që komisioni hetimor të shtyhet 2 muaj, nuk ekziston vullneti politik i palëve për të ndodhur kjo. Kjo ishte për interesin e gojëve të liga dhe të kujtdo tjetër, që është i interesuar të dijë për punën e këtij komisioni, të cilët flasin lart e poshtë, pa marrë parasysh fakte dhe prova, ashtu siç kemi bërë ne gjatë gjithë kësaj kohe.

Njëkohësisht, dua të njoftoj për këtë shkresën...

Urdhëroni!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Në mbledhjen e komisionit hetimor të datës 19 janar ishte vendosur në rendin e ditës edhe diskutimi i pikës, që ka lidhje me zgjatjen e afatit hetimor, por sikundër, në fakt, dëshmohet edhe nga pamjet filmike të asaj mbledhjeje, kjo pikë nuk është pranuar të diskutohet në fund të mbledhjes nga kryetarja e komisionit. Meqenëse kërkuarit e këtij komisioni kanë qenë vazhdimisht kontradiktorë me afatin e mbarimit të punës së këtij komisioni, po Kuvendit të Shqipërisë, po Kryetares së Kuvendit i është kërkuar të mbledhë Këshillin e Rregullores dhe Mandateve. Këshilli i Rregullores dhe Mandateve në vendimmarrjen e tij ka konfirmuar qartësisht që afati i komisionit hetimor nuk është një afat i parashikuar në Rregullore, por është një afat i vendosur në vendimin e Kuvendit të Shqipërisë, sipas kërkesës së kërkuarëve. E theksoj këtë, sepse, në fakt, ligji për komisionet hetimore thotë se Kuvendi i Shqipërisë nuk mund ta

imponojë afatin. Afatin e kërkon kërkuesi dhe tri muaj ka qenë afati i kërkuar. Sidoqoftë, në frymën e tolerancës dhe të bashkëpunimit, në një mbledhje, ku nga Partia Demokratike kanë qenë vetëm dy përfaqësues, zoti Alibeaj dhe zoti Salianji, është diskutuar dhe është vendosur që puna e këtij komisioni të zgjasë deri në datën 25 shkurt 2022. Kështu që kjo është çështja, pra kërkesa e datës 20.12.2021 për shumë arsye tani është një kërkesë nul, e pavlefshme që nuk ka pse të tërheqë më vëmendjen e askujt.

Jorida Tabaku – Nuk kam ndërmend që të futem në debat me zonjën Felaj. Interesi publik për këtë temë ishte a kemi kërkuar apo jo shtyrje të afateve të komisionit hetimor. Nuk dua fare ta heq vëmendjen nga afëra më e madhe korruptive e Tiranës që do të prezantojmë sot.

Te pjesa e njoftimeve, dua të njoftoj kolegët dhe të gjithë të interesuarit që një javë më parë, pasi u mbajtën dy javë nga sekretarja e komisionit, janë nisur disa shkresa: në datën 4 shkurt kryetarit të Bashkisë së Tiranës, zotit Erion Veliaj, zonjës Mirela Kumbaro, ministre e Mjedisit, zonjës Belinda Balluku, ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, zonjës Delina Ibrahimaj, ministre e Financave dhe Ekonomisë, zotit Ëngjëll Agaçi, sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, zonjës Arta Dollani, drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

(këtu kam shkresën që nuk është miratuar nga zonja Dhima, kërkoj ndjesë), zotit Ceno Klosi, drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve, zonjës Pranvera Fagu, drejtoreshë e Përgjithshme e Qendrës Kombëtare të Biznesit, zotit Arben Shehu, kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, zonjës Brunilda Lilo, avokat i Përgjithshëm i Avokaturës dhe zonjës Ledia Tota, drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit. Dua të njoftoj komisionin që sot, 7 ditë pasi janë nisur, 5 ditë pune dhe 7 ditë kalendarike, nuk kemi përgjigje. Dua t'u kërkoj ekspertëve të komisionit dhe specialistëve të komisionit të ngremë një padi për këdo që nuk kthen përgjigje brenda kohës. Rruga e butë ka përfunduar në këtë komision. Ju lutem, për këdo, që nuk ka kthyer përgjigje brenda ditës, të bëjmë një padi për këta persona. Është shumë e rëndësishme përgjigjja e Drejtorisë së Tatimeve, e theksoj. Një pjesë tjetër ne mund t'i kemi këtu edhe si dëshmitarë në komision.

Dukë përfunduar këtë njoftim, procesverbalin e mbledhjes së kaluar ne nuk e kemi gati, pasi mbledhjet po ndodhin shumë shpejt dhe stafi i komisionit është i angazhuar edhe me punë të tjera. Do t'i miratojmë të gjitha bashkë, kur ne t'i kemi procesverbalet me radhë.

Përpara se të filloj mbledhjen, dua t'ua kërkoj të pranishmëve këtu, nëse ndonjëri nga të pranishmit e opozitës ose të maxhorancës ka konflikt interesi në çështjen e inceneratorit të Tiranës, nëse dikush nga të pranishmit këtu ka një konflikt interesi, është përfshirë në vendimmarrje për inceneratorin e Tiranës, dua t'i kërkoj që të mos marrë pjesë në diskutime, ashtu siç e kërkon ligji për konfliktin e interesit, t'i deklarojmë konfliktet e interesit që në fillim të mbledhjes dhe të procedojmë.

Zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Në fakt, nuk e di çfarë kuptoni ju me konflikt interesi, sepse ju jeni kallëzuesi dhe po hetoni. A dini ndonjë rast kur ai që kallëzon, edhe heton, edhe jep vendimin e dënimit, ma thoni? Në qoftë se ky nuk është konflikt interesi, pastaj gjejini tjetërkund konfliktin e interesit.

Jorida Tabaku – Konflikt interesi është: a është ndonjëri nga i përfshirë në vendimmarrjen e inceneratorin e Tiranës?

Ermonela Felaj – Para se të ma drejtoni mua këtë pyetje, duhet t'ia drejtoni vetes, sepse keni bërë kallëzim për këtë çështje, në rregull. Kështu që konflikti interesit në rastin konkret, ashtu si e kuptoni ju, nuk ekziston.

Edmond Spaho – Kjo është një kërkesë fare normale në vendimmarrje, dhe këtu jemi në një komision që hetojmë dhe marrim vendimet. Ndonjëri nga ne këtu mund të ketë qenë pjesë e procesit. Nuk ka asgjë të keqe. Të sigurohemi që nuk kemi qenë pjesë e procesit. Kush ka konflikt, e thotë vetë nëse ka; nëse nuk ka, do të vazhdojmë.

Jorida Tabaku – Sjell edhe një herë në vëmendjen e komisionit konfliktin e interesit, sepse kam një shkresë të zonjës Ermonela Felaj të përfshirë në procedurën e koncensionit të Tiranës, që ka qenë miratuese e njëjës prej fazave. Për këtë arsye dua që të jemi të gjithë të qartë që askush nuk ka pasur vendimmarrje në inceneratorin e Tiranës. Është një lloj konflikti tjetër interesi nga ai i kallëzuesit. Ne nuk kemi qenë palë në procesin e miratimit dhe të dhënies me koncesion dhe ky është një shqetësim i drejtë. Kush është jurist, besoj se e kupton më mirë se ne të tjerët që jemi thjesht ligjvënës dhe nuk jemi me profesion juristë. Besoj se është një e drejtë, sipas ligjit.

Ju gjykoni se jeni në rregull? Në rregull.

Së pari, të nderuar kolegë, dua të filloj me prezantimin e dosjes së inceneratorit të Tiranës. Ajo që ka ndodhur me Fierin dhe me Elbasanin dhe këdo që i del në mbrojtje, që ka

karakterin, moralin, etikën dhe lëkurën shumë të trashë, nuk i skuqet dhe nuk i zverdhet, që mbron një aferë korruptive, ashtu siç është kjo e inceneratorëve, besoj se në inceneratorin e Tiranës do ta ketë akoma edhe më të vështirë.

E gjithë afera e inceneratorit të Tiranës, fatkeqësisht, lindi në landfillin e Sharrës, me vrasjen e Ardit Gjoklajt. Ardit Gjoklaj sot nuk jeton më. Ishte një djalë i një familje të varfër. Zoti Këlliçi e ka takuar familjen e tij, i cili punonte në landfillin e Sharrës dhe askush nuk e ka sqaruar se çfarë ka ndodhur atë ditë kur Ardit Gjoklaj ka humbur jetën.

Fatkeqësisht, puna e këtij komisioni nuk ka arritur dot dhe nuk do të arrijë dot të hedhë dritë mbi këtë aferë, por ajo që na takon për inceneratorin e Tiranës besoj se fillon në datën 28.06.2016. Në përgjigje të një letre interesi, dërguar një bashkim kompanish “*Energy Recuperator*”, e përfaqësuar nga zoti Klodian Zoto aksioner, zoti Klodian Mërtiri apo Mirel Mërtiri (emrat duhet t’i sqarojë gjykata, se keni disa emra) administrator, me zyrë në “*Sky Tower*” me të njëjtën zyrë dhe me të njëjtën adresë, ku ndodhet edhe zyra e inceneratorit të Fierit dhe të Elbasanit, por, në ndryshim me një emër tjetër kompanie, në bashkëpunim me kompaninë “*Paul Wurth Italy*”, e regjistruar në Holandë, i kthehet një përgjigje nga ana e ministrit të Mjedisit, Lefter Koka, dhe vendos në dijeni edhe kryetarin e Bashkisë, Erion Veliaj.

“*Paul Wurth*” i përfshirë në këtë incenerator dhe në këtë koncesion është përpjekur të kontaktohet nga përfaqësues të Partisë Demokratike, zonja Flutura Açka ka shkuar në zyrat e “*Paul Wurth*” për t’u interesuar, nuk ka arritur dot që të gjejë, ka qenë një adresë e një apartamenti në Amsterdam, ku “*Paul Wurth*” duhet të kishte zyrat, ndërkohë që “*Paul Wurth International*” i ka zyrat në një adresë tjetër. Kështu që unë besoj se kjo duhet të jetë edhe një nga pikat, ku duhet të fokusohet edhe hetimi i prokurorisë.

Me urdhrin nr. 169 “Për ngritjen e komisionit për dhënien me koncesion të inceneratorit” ngrihet ky komision nga ministri i Mjedisit.

Në datën 28.09.2016 Ministria e Mjedisit i ka nisur menjëherë një shkresë ministrit të Financave, Arben Ahmetaj, “Kërkesë për miratim paraprak”. Aty sqarohet Ahmetaj, situata me mbetjet dhe, gjithashtu, i parashtrohet edhe komisioni që ky ka ngritur në datën 5 shtator që të marrë hapat e tjerë proceduralë, duke përfunduar studimin e fizibilitetit. Pra, ka një studim fizibiliteti që ekziston, thotë ministri Lefter Koka. Në këtë letër thuhet se kostoja e këtij projekti është 140 milionë euro dhe bashkitë, pjesë e qarkut të Tiranës, do të paguajnë tarifën e depozitimit në këtë projekt, mbi bazën e sasisë së mbetjeve që atë do të gjenerojnë dhe kjo do të

jetë një formulë partneriteti publik-privat. Gjithashtu, propozohet, që e gjithë shuma, të mbulohet 100% nga buxheti i shtetit.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Ministria e Financave kthen një përgjigje, ku thotë se nuk ka studim fizibiliteti draftkontrata dhe, gjithashtu, i kujton se duhet të garantohen kostot përkatëse të projektit. Se ju kujtoj,- thotë ministri i Financave, - se nuk janë të parashikuara ne tavanet buxhetore dhe nuk ka buxhet për këtë projekt. Komisioni i inceneratorit ndërkohë ka vendosur që t'u japë një bonus 8 nga 10 pikë kompanive që kanë aplikuar për këtë projekt.

Në datën 07.11.2016 me shkresën me nr. 5474/8 nga Ministria e Mjedisit u kërkohet mendim disa ministrave të qeverisë shqiptare. Është shume e rëndësishme që të dimë ministrat që janë përfshirë, njëkohësisht edhe përgjigjet: Ylli Manjani Arben Ahmetaj, Milva Ekonomit, Ermonela Felaj dhe Damian Gjiknurit, së bashku edhe me projektvendimin. Shkresa ishte për miratimin e bonusit për procedurën përzgjedhëse konkurruese që i është dhënë inceneratorit të Tiranës.

Në datën 15.11.2016 me këtë shkresë, që unë e kam sot këtu, zonja Ermonela Felaj, zëvendëskryetare e këtij komisioni hetimor, i kthen përgjigje zotit Lefter Koka dhe Ministrisë së Mjedisit e ngre disa shqetësime si ministre e Shtetit që mbulon Marrëdhëniet me Parlamentin, thotë: “Bonusin e fiton kompania “*Integrated Energy*”, e cila nuk është regjistruar në QKB”. Pra, i keni dhënë bonusin një kompanie që nuk ekziston në QKB, nuk është regjistruar.

Duhet përcaktuar cilësitë pozitive dhe negative të projektit, përlllogaritjet e impaktit ekonomik dhe atij në ambient. Kujtojmë, po krijohet një incenerator, i cili akoma nuk ka konsultim për çështjet e mjedisit dhe, sigurisht, nuk ka akoma lejen, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe të gjitha procedurat e tjera.

Për ujërat e ndotura, - thotë zonja Felaj, - duhet të konfirmoni mos ka mbivendosje me projektin e Xhajakës së Japonisë që ekziston, sepse, siç do ta diskutojmë në vijim, loti 6 i punimeve për inceneratorin e Tiranës përfshin edhe ndërtimin e impiantit të ujërave të ndotura. Kur të shkojmë atje, do të shohim nëse ka impiant të ujërave të ndotura të ndërtuara që duhej të kishte përfunduar para dy vjetësh apo jo.

Në datën 15.11.2016, ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, i përgjigjet dhe i thotë: “Procesi duhet të konsultohet me të gjitha palët e interesit. Këshilli e Ministrave nuk ka punë.” Nëse dje e mbronin Këshillin e Ministrave të procedura e Elbasanit dhe thoshin se Këshilli i Ministrave ka

dhënë dakordësinë financiare që nuk duhet ta jepte, këtu thuhet se Këshilli i Ministrave nuk ka punë për t'u përfshirë në këtë proces. Ministria e Drejtësisë propozon që të rivlerësohet edhe një herë nisma dhe të zbatohet ligji në fuqi.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës i është përgjigjur letrës së Kokës, duke u shprehur se është kompetencë e autoritetit kontraktues të japë bonusin dhe mund të vazhdojnë me procedurën.

Ministria Zhvillimit Ekonomik ka kthyer përgjigje dhe ka thënë se ATRAKO është pjesë e grupit të punës. Drejtoreshën e ATRAKO-s do ta kemi këtu për ta dëgjuar për të tria procedurat në javët në vijim.

Ministria e Mjedisit i kthen përgjigje zonjës Ermonela Felaj dhe i thotë: “Vlerësimi me pikë nuk do të thotë që procesi është i paracaktuar (dhe jep shembullin e Fierit), edhe në Fier kështu e kemi bërë thotë”. E kemi shkelur ligjin atëherë në Fier, duhet ta shkelim edhe tani në Tiranë, atë inceneratorin e Fierit që zonja Felaj e mbrojti dy ditë më parë. Vlerësimi i projekt është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve, kështu që ne do të vazhdojmë.

Në datën 25 Ministria e Mjedisit i ridërgon një shkresë Ministrisë së Drejtësisë dhe i thotë: “Projektvendimi i miratimit të bonusit nuk ka pse shoqërohet nga studimi i fizibilitetit, bonusin duhet ta japë Këshilli i Ministrave.” Pra, Këshilli i Ministrave në fund të ditës paska qenë i përfshirë, sepse edhe në rastin e Fierit e dha po Këshilli i Ministrave bonusin! Ministria e Drejtësisë po i tejkalon kompetencat e saj. Ftohet Ministria e Drejtësisë ta miratojë sa më shpejtë, pasi Bashkia Tiranë mezi po e pret këtë projekt.

Në datën 30.11.2016, zonja Rovena Vodo (besoj se ju kujtohet të gjithëve, është person sot para drejtësisë, shefe e kabinetit të ministrisë së zonjës Ermonela Felaj) i dërgon një shkresë, pa arritur që të marrë një përgjigje për të gjitha pyetjet që kishte ngritur. Në kopje në *e-mail* është edhe zoti Artur Metani (unë e kam përgjigjen edhe të *e-mail-it*), edhe zoti Alqi Bllako. Këtu shfaqet edhe zoti Alqi Bllako dhe i thotë që jemi dakord për këtë projekt, pa ndodhur asgjë, pa plotësuar kushtet.

Po në datën 30 Ministria e Financave i dërgon një përgjigje Ministrisë së Mjedisit për miratimin e bonusit dhe i thotë që Bashkia e Tiranës nuk e ka të miratuar këtë projekt. Nuk e ka në fondet buxhetore. Nuk ekzistojnë fondet. Nuk është e qartë se me çfarë do të paguhen 140 milionë euro. Formula financiare ngre pikëpyetje, nuk është e saktë. Projektakti për vlerësimin

me pikë duhet të jetë individual i ministrit. Nuk duhet të kalojë në Këshillin e Ministrave. “Nëse ky koncesion PPP-i kërkon mbështetje financiare, duhet të merret miratimi paraprak nga Ministria e Financave për këtë koncesion”, është përgjigjja e zotit Ahmetaj.

Ministria e Drejtësisë ngre sërish të njëjtat shqetësime në datën 02.12.2016, ku thuhet se nuk është konsultuar, procedurat janë në shkelje, nuk mund ta marrë Këshilli i Ministrave vendimin për bonusin. Por çfarë ndodh vetëm 5 ditë pas kësaj?! Në datën 07.12.2016 mblidhet Këshilli i Ministrave dhe me VKM-në nr. 855 miratohet bonusi, çuditërisht për procedurën koncensionare të inceneratorit të Tiranës. Pra, 5 ministra, duke përfshirë edhe ministrin e drejtësisë që thonë se bonusi duhet dhënë me karakter individual; nuk duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave; duhet të mbajë përgjegjësi Lefter Koka që është sot para burgut; nuk duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave, ndërkohë që Këshilli i Ministrave papritur e miraton.

Për këtë pyetje dhe për mbrojtjen kolektive, sepse këtu nuk është më përgjegjësi individuale, është kolektive do të na japë përgjigje sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit dhe Kryeministri kur të vijnë këtu.

Pse kanë shkelur ligjin, kur ministrat thonë se është përgjegjësi individuale dhe thonë se bonusi jepet nga autoriteti kontraktor? Këtë e ka dhënë Këshilli i Ministrave. Kë kanë dashur të mbrojnë?

Në datën 27.12.2016 Ministria e Mjedisit i nisi një shkresë Ministrisë së Financave, sepse ka shumë komunikime, shkresa midis Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Financave për këtë çështje, ku i ridërgon për miratim procedurën koncensionare, që tashmë që e ka iniciuar për inceneratorin e Tiranës; studimin e fizibilitetit nga komisioni i koncesionit, pra studimi i fizibilitetit nuk ekzistonte, ashtu siç gënjyen në shkresën e parë; kostoja totale thotë se është 29 euro për ton. Se ku arriti të jetë kostoja totale 29 euro për ton, ne nuk kemi asnjë dokument zyrtar si është arritur në këtë shifër.

“Duke qenë se bashkitë Tiranë, Vorë, Kavajë dhe Kamëz nuk disponojnë të ardhura të mjaftueshme”, -thotë Ministria e Mjedisit, që në letrën e mëparshme thoshte se Bashkia Tiranë ka të gjitha fondet, atëherë i kërkojmë qeverisë që të marrë përsipër t’i mbulojë këto institucione, Bashkia Tiranë do të marrë përsipër të mbulojë vetëm 700 tonë mbetje në ditë. Ministria thotë që vlera, ndryshon mendje, është 91 milionë euro. Pra, nga 140, shkoi 91 milionë euro. U kërkoj të gjithë anëtarëve të komisionit të mbajnë mend shifrën me të cilën nisi, sepse këtu fillon procedura, 91 milionë euro.

Fillon viti 2017. Më 01.02, Ministria e Mjedisit i nis përsëri një shkresë Ministrisë së Financave. Shkresa është në përgjigje të një shkrese. Ka ndodhur diçka shumë e çuditshme me shkresat e këtij komisioni hetimor. Që nga ky moment e deri në fund shkresat e Ministrisë së Financave janë hequr. Kemi vetëm përgjigjet e Ministrisë së Mjedisit ndaj Ministrisë së Financave, por nuk kemi çfarë i kërkojmë Ministrisë së Financave. Mund t'i kuptojmë sigurisht nga përgjigjet, por janë hequr të gjithë shkresat e Ministrisë së Financave.

“PPP-ja është një mënyrë shumë europiane. Na afron me integrimin europian PPP-ja” - thotë zoti Lefter Koka, ndërkohë që raporti i Komisionit Europian, progresraporti thotë që incenerimi është mënyra më e pak e dëshiruar, është në shkelje të MSA-së, por, njëkohësisht, është në shkelje edhe të një sërë ligjeve të tjera, që lidhen me menaxhimin e mbetjeve. Duhet garantuar 700 tonë mbetje në ditë, dhe këtu ngrihet për herë të parë çështja e pronës.

Çështja e pronës për inceneratorin

“Toka ku do ndërtohet impianti është në pronësi të shtetit, 60% është në pronësi të Bashkisë Tiranë, ndërkohë që 39,9% është pronë private dhe do shpronësohet me 200 milionë lekë, do të përballohet nga Bashkia Tiranë dhe do t'i kalojë Bashkisë Tiranë. Projekti nuk është planifikuar në tavanet buxhetore të Ministrisë së Mjedisit, pasi ky projekt nuk do të paguhet nga qeveria”. Ky është i njëjti justifikim, besoj se të gjithëve u kujtohet justifikimi i zotit Ahmetaj: “Koncensionet nuk i paguan buxheti i shtetit”. Edhe këtu nuk e paguan qeveria, por e paguan Bashkia e Tiranës, nuk është i njëjti thes, nuk janë para të taksapaguesve. Për pjesën e detyrimeve do të diskutojmë sesi do të procedohet.

Ministria e Mjedisit thotë: “Shumat e vëna në dispozicion nga ana e Bashkisë së Tiranës janë të disponueshme. Bashkia e Tiranës i ka të gjitha fondet”, por ndërkohë çfarë ndodh?! Bashkia Tiranë merr një vendim 59 të këshillit bashkiak, ku parashikon rritjen e tarifave të pastrimit, dhe siç shkruhet në relacion, me justifikimin për të mbuluar kostot e inceneratorit të Tiranës. Tarifat e pastrimit, sipas këtij vendimi të këshillit bashkiak, rriten nga 15 deri në 64% për të gjitha bizneset, por ajo që është më e rëndësishmja për të gjithë qytetarët, për të paguar koston e inceneratorit në Tiranë, sepse, siç po e kuptojmë, fondet nuk ekzistojnë, nuk janë fondet, nuk ekzistojnë fondet për inceneratorin e Tiranës.

Në datën 21.02.2017 Ministria e Mjedisit i dërgon një shkresë ministrit Ahmetaj, përsëri shkresën nuk e kemi të ministrit Ahmetaj, por kemi vetëm përgjigjet. Ministria e Mjedisit nuk ka vendosur tavane, sepse thotë që nuk do ta paguajmë ne, nuk ka fonde buxhetore për

inceneratorin. Edhe një herë, Bashkia e Tiranës do t'i mbulojë shpenzimet, ndërkohë që nga analiza e buxhetit të Bashkisë së Tiranës nuk ka fonde në buxhetin e Bashkisë së Tiranës për inceneratorët në vitin 2017 dhe, sigurisht, ligji i cakton Bashkisë së Tiranës miratimin e tavaneve buxhetore, të cilat miratohen edhe në Ministrinë e Financave.

“Bashkisë së Tiranës dhe Ministria e Mjedisit nuk mund të identifikojnë një koncensionar më të saktë se këto të dy që kanë aplikuar”, thotë Ministria e Mjedisit, ose i bën Klodian Zoto dhe Mirel Mërtiri, ose nuk i bën asnjë tjetër në Republikën e Shqipërisë inceneratorë. Kjo është përgjigjja e Ministrisë së Mjedisit. Ministria e Mjedisit thotë përsëri që projekti nuk ka asnjë efekt shtesë në buxhetin e shtetit dhe përsëri gënjen. Nuk ka asnjë efekt në buxhetin e shtetit dhe e nis me koston 90 milionë euro. Nuk paguhet nga transfertat e pakushtëzuar, thotë.

Në datën 28.02.2017 Ministria e Mjedisit i dërgon një shkresë, përmes Alqi Bllakos, kryetarit të Bashkisë së Tiranës, ku i kërkon që të miratohen procedurat koncensionare, shkresa nr. 5474/26. Ministri Ahmetaj i kthen një përgjigje Ministrisë së Mjedisit dhe i thotë, edhe një herë kjo, pas një viti përsëri për herë të 5-të, “Duke qenë se në studimin e fizibilitetit shpreheni se qarku i Tiranës është financuesi dhe përfituesi (ndërkohë siç iu shpjegova qarku i Tiranës, Bashkia e Tiranës nuk i ka fondet) i këtij projekti, ne kërkojmë nga ana juaj miratimin me shkrim nga ky qark, referuar modelit financiar që do të ndiqni”. Bashkia e Tiranës i kthen një përgjigje me shkresën nr. 32/75 të sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Alqi Bllako, se është parimisht dakord për sa i përket rolit të saj. Ndërkohë, unë kam këtu shkresën e kryetarit të Bashkisë së Tiranës për këtë çështje dhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, i cili dërgon një shkresë që merr përgjegjësi për inceneratorin e Tiranës, kalon kompetencat e tij thotë, Kontrolli i Lartë i Shtetit. Kryetari Bashkisë Tiranë është përgjegjës vetëm për Bashkinë Tiranë, nuk është përgjegjës për qarkun Tiranë. Pra, ka marrë përgjegjësi financiare që nuk i takojnë. Kryetari i Bashkisë së Tiranës ka shkelur ligjin për financimet publike dhe menaxhimin e shpenzimeve buxhetore, ka marrë përgjegjësi jashtë tavaneve buxhetore për një projekt që nuk dihet sa është kostoja. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, më e rënda, ka dërguar një shkresë në emër të tij dhe ka marrë përgjegjësi dhe autoritet të këshillit bashkiak në Tiranë. Kryetari i Bashkisë së Tiranës është përgjegjës për propozimin e buxhetit të këshillit bashkiak Tiranë. Këshilli bashkiak Tiranë është përgjegjës për miratimin e buxhetit, ai angazhohet financiarisht për vendime të Këshillit Bashkiak të Tiranës për vitet në vijim, ndërkohë që nuk i ka fondet. Kryetari i Bashkisë Tiranë

bën 4 shkelje me shkresën që nis. Kjo e vërtetuar nga raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili i është dhënë këtij komisioni hetimor dhe ne e disponojmë.

Për të vijuar: Ministria e Mjedisit dërgon përsëri një shkresë, ku kërkon miratimin, duke i kërkuar edhe një herë dakordësinë. Ministria e Financave i dërgon një shkresë Ministrisë së Mjedisit, ku i thotë se kontrata koncesionare ka dy risqe shumë të mëdha. Kontrata koncesionare ka riskun e kursit të këmbimit dhe riskun e inflacionit dhe, përsëri i thotë, duhet të merrni miratim nga të gjitha bashkitë e qarkut Tiranë, jo vetëm nga Bashkia e Tiranës. Ua rikujtojmë edhe njëherë që jeni duke shkelur ligjin, po cenoni autonominë vendore dhe ligjin për funksionet e pushtetit vendor dhe po merrni përgjegjësi që nuk ju takojnë. Unë e kam këtu kontratën koncesionare, të cilën e kemi analizuar në detaje.

Nuk kam parë, me aq pak kontrata sa kam lexuar unë dhe me aq sa dimë të lexojmë ne, me kulturën tonë juridike modeste, kontratë më diskriminuese për shtetin shqiptar se kontrata e inceneratorit. Kontrata e inceneratorit Tiranë është në euro. Nuk kam lexuar kontratë tjetër në euro, mund të ketë kontrata të tjera në euro, ndryshon sipas kursit të këmbimit, është një risk i shtuar. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka gjetur shkelje, unë do t'jua lexoj pak më vonë këtë. Kontrolli i Lartë i Shtetit thotë që risku i kurseve të këmbimit i ka kushtuar qeverisë shqiptare një kosto shtesë, që unë do ta prezantoj më vonë. Kontrolli i Lartë i Shtetit thotë që kontrata merr përsipër inflacionin. Çfarë ndodh sot që kemi një inflacion 3,6% dhe që pritet të rritet? Siç thotë qeveria: “është normale, ndodh në të gjithë botën”, por a e dini se çfarë ndodh?! Pagesat e inceneratorit Tiranë sot indeksohen me normën e inflacionit, çdo ditë i paguhet ndryshe inceneratorit Tiranë, sepse kështu e kanë shkruar në kontratë. Ministri i Financave, i asaj kohe, e ka ngritur këtë shqetësim, por nuk është marrë parasysh. Ministria e Mjedisit i dërgon shkresë përsëri Ministrisë së Energjetikës për shitjen e energjisë, duke qenë se është përgjegjës për politikën energjetike. Kemi një memo nga grupi i komisionit. Zonja Ballgjini do të vijë këtu dhe do ta pyesim si dëshmitare drejtuar ministrit Lefter Koka, por, njëkohësisht, sigurisht, zoti Alqi Bllako i përfshirë, si në çdo procedurë, ku paraqitet vlerësimi i procedurës paraprake, dhënie me koncesion, ku jepet një sugjerim për të vazhduar, pavarësisht gjithë këtyre problemeve të procedurës. Bëhet shpallja publike e koncesionit në datën 16 prill dhe 24 dhe, njëkohësisht, bëhet edhe botimi në gazetën “*The Economist*”, ku ne kemi një urdhër pagese prej 6500 paund. E përmend këtë, sepse është një element shumë i rëndësishëm, urdhri i pagesës për “*The Economist*”, sepse, ndërkohë që procedura është hapur më 24.07, procedura është mbajtur hapur

vetëm 36 ditë. Sipas legjislacionit, procedurat ndërkombëtare duhet të jenë të hapura 52 ditë, në mënyrë që t'u lejojnë të gjithë ofertuesve ndërkombëtarë që të paraqitin oferta serioze, sidomos për projekte të cilat shkojnë në 430 milionë euro është e nevojshme që të kemi studime të plota, nuk lejohet, 36 ditë mbahet hapur në gazetën “*The Economist*”, pas një pagese 6500 paund që bën qeveria shqiptare, duke shkelur përsëri po vetë ligjin.

Procesverbali i takimit të komisionit të vlerësimit të procedurës koncesionare

Depozitohen ofertat për dhënien me koncesion dhe ndodh mbledhja më e shpejtë e procedurës koncesionare, fillon në orën 11:00 dhe mbaron në orën 11:05. Paraqiten vetëm 2 përfaqësuesit, që unë lexova në fillim, kompania *Energy Recuperator*, me zotin Klodian Zoto, Paul Wurth, ku, sipas asaj që ju tregova, zonja Flutura Aça shkoi në adresën e shënuar në dokumentet e koncesionarit dhe është një apartament, ku nuk banon askush në Amsterdam në Holandë.

Nga Bashkia e Tiranës, papritur, në datën 31.07 dërgohet një shkresë dhe thuhet se si rezultat i njoftimit për hapjen e procedurës koncesionare do të tërheqim nga procedura koncesionare përfaqësuesin tonë zotin Taulant Tusha, në mos gaboj, sepse ekziston një VKM, që pezullon të gjitha procedurat e koncesionit në vitin 2017. Pra, Bashkia e Tiranës për një periudhë kohe nuk kishte përfaqësues të saj në këtë komision. Komisioni i dhënies së koncesionit i dërgon një letër Klodian Zotos, ku i thotë se e ke fituar koncesionin. Pas të gjitha këtyre që unë lexova, pas një viti shkresash, ministrash që thonë jo, që nuk e ekziston, që nuk ekzistojnë fondet buxhetore, që po shkelni ligjin, që kryetari i Bashkisë së Tiranës shkel ligjin, miratohet procedura koncesionare dhe njoftohet fituesi. Ministria e Mjedisit ka paraqitur si ministër, me vendimin numër 1 të kësaj date, se kjo kompani është fituese. Por çfarë ndodh? Në qoftë se Bashkia e Tiranës kishte tërhequr përfaqësuesin e saj, zotin Taulant Tusha nga komisioni i koncesionit, zoti Taulant Tusha tashmë e ka firmosur këtë koncesion. Pra, megjithëse ishte tërhequr nga procedura, ka shkuar dhe ka miratuar këtë koncesion. Ministria e Mjedisit e njofton APP-në për fituesin, Ministria e Mjedisit i dërgon edhe Avokaturës së Shtetit kërkesë për sa i përket kontratës koncesionare, që unë lexova këtu më poshtë. Këtu do të vijë avokatja e Shtetit, kemi edhe mendimin e avokates së Shtetit, do të shohim sa janë marrë parasysh kërkesat e Avokaturës së Shtetit për këtë kontratë abuzive, ku të gjitha risqet i mban shteti dhe asnjë risk nuk mban koncesionari dhe më pas publikohet kontrata e nënshkruar nga të

gjitha palët. Harrohen të gjitha shqetësimet që ishin ngritur në këtë një vit e gjysmë dhe konsiderohet sikur kjo është një procedurë normale koncensionimi.

Ndërkohë, çfarë ndodh?! Mbyllet Porto Romano, pra me një vendim abuziv mbyllet Porto Romano. Edhe këtu kemi një tender, ku është shfaqur, sigurisht, zoti Klodian Zoto, përfitues i këtij tenderi dhe pas vendimit abuziv, siç u ngrit në këmbë Bashkia e Elbasan, që Qazim Sejдини brenda ditës e nisi shkresën dhe tha kemi gjendje emergjence, ngrihet edhe Bashkia Durrës. Në vendimin numër 533 i këshillit bashkiak Durrës, që shpall emergjencën mjedisore në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, kërkohet që të shpallet emergjenca te Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, të gjejmë, thotë, papritur një metodë alternative, sepse nuk e dinë ka apo nuk ka metoda alternative, dhe kërkohet mbështetje nga kryetari i bashkisë.

Ndërkohë kemi një vendim të Këshillit të Ministrave nr. 811 për shpronësimet në inceneratorin e Tiranës, që thanë se do të paguhet nga Bashkia e Tiranës, por që, fatkeqësisht, nuk paguhet nga Bashkia e Tiranës. Kemi përsëri një vendim nr. 50 të Këshillit Bashkiak Tiranë, e cila miraton shpalljen e emergjencës për fushën e mbyllur venddepozitimit të Porto Romanos dhe autorizon kryetaren e bashkisë, zonjën Emirjona Sako, e cila, në fakt, nuk është kryetare bashkie, por e emëruar në Bashkinë e Durrësit, ku kanë hyrë e kanë dalë shumë kryetarë dhe është bërë si drejtoreshë komunale, e kanë autorizuar që të lidhë një marrëveshje me koncensionarin. Asaj i thonë lidhe ti marrëveshjen me koncensionarin, pa procedura koncensionare, 10 milionë euro, të cilën unë e kam këtu dhe e kemi publikuar, pa asnjë lloj procedure me koncensionarin e Tiranës për të çuar mbetjet atje. Unë, zonja Zhupa, zoti Këlliçi kemi qenë kur kjo ndodhte, në fakt, dhe kur kjo ndodhte kamionët e Durrësit rrinin të rreshtuar te landfilli i Sharrës, nuk i pranonin, Durrësi digjej, mbetjet digjeshin, qytetet shqiptare digjeshin që t'i çonin mbetje inceneratorit të Tiranës dhe të paguhej. Rrinin atje kamionët të rreshtuar, sepse nuk ishte bërë pagesa, deri kur zonja Emirjona Sako negocioi me Klodian Zoton dhe Mirel Mërtirin dhe bëri pagesën 10 milionë euro. Kam vendimin e Këshillit Bashkiak të Durrësit që janë rritur tarifat e pastrimit të Durrësit për të përballuar pagesën e inceneratorit të Tiranës.

Ndërkohë që këto ndodhnin Kontrolli i Lartë i Shtetit bën dy raporte, unë do të prezantoj të parin, zonja Zhupa do të prezantojë të dytin. Çfarë ndodh, sipas raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por, njëkohësisht, i kryqëzuar edhe me të dhënat e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, e cila ka paraqitur raporte monitorimi financiar për inceneratorin e Tiranës. Deri në

fund të vitit 2018, thotë raporti i Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë në këtë rast në fund të vitit 2019, është realizuar vetëm 6% e ndërtimit nga 30% i projektuar, thotë Ministria e Financave që duhet të kryejë. Unë i kam këtu të gjitha pagesat në çdo vit që nga viti 2018 e në vijim se sa ka paguar shteti dhe sa ka investuar konkensionari. Shteti, ndërkohë që flasim deri më sot, ka bërë 135 pagesa në thesar për inceneratorin e Tiranës, 36 milionë euro, ndërkohë që inceneratori i Tiranës, konkensionari, në vitin që flasim, në vitin 2019, ka bërë 6% të investimit nga 30% të investimit.

Pyetja që kam unë është: në kontratën konkensionare ka disa penalitete dhe gjopa për kompaninë konkensionare, të cilat ne i kemi analizuar me kujdes. Neni 19 thotë: “Mosrespektimi i afateve të punimit, nga data e fillimit të punimeve, do të çojë në penalitete nga autoriteti kontraktor dhe nga njësia e zbatimit të projektit”. Penalitetet janë si më poshtë vijon: 400 euro në ditë, nëse vonohet 60-90 ditë; 800 euro në ditë, nëse vonohet 90-120 ditë; 1250 euro në ditë, nëse vonohet 121-180 ditë dhe 2250 euro në ditë, nëse vonohet më shumë se 300 ditë. Këtu ne kemi vonesa me vite. A ka marrë ndonjëherë gjobë inceneratori i Tiranës për këto vonesa dhe penalitete? A është zbatuar ndonjëherë kontrata konkensionare në zbatim të detyrimeve të konkensionarit, por vetëm në detyrim të zbatimeve të shtetit, sepse siç e thashë edhe më parë risku që ka për shtetin kjo kontratë konkensionare është i jashtëzakonshëm?

Ndërkohë, përsëri deri në vitin 2021, Ministria e Financave ka po të njëjtat raporte. Referuar tabelës, thotë Ministria e Financave, në vitin 2018 kanë investuar vetëm 20% të asaj që duhej të kishin bërë. Në vitin 2019 është akoma më keq gjendja, 2,8% konkensionari, sipas asaj që duhej bërë. Nuk ka asnjë forcë madhore, asnjë shkak madhor. Kontrata thotë se cilat janë forcat madhore dhe shkaqet madhore, janë të përcaktuara atje. Nuk është zbatuar kontrata, por a janë vendosur penalitete? Pse nuk është mbajtur konkensionari përpara përgjegjësisë?

Në total është investuar 31,7%, thotë dokumenti zyrtar i shtetit, Ministria e Financave, Kontrolli i Lartë i Shtetit, nga ajo që duhej të kishte investuar konkensionari, një e treta e vlerës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ngre të njëjtat shqetësime që ngrita unë sot këtu. Risku që vjen nga fakti që Bashkia e Tiranës e ka marrë vetëm përsipër këtë pa pasur fondet. Kontrolli i Lartë i Shtetit e gjykon këtë se kjo është një shkelje, edhe sipas ligjit në fuqi. Dakordësia e Bashkisë Tiranë në lidhje me inceneratorin e Tiranës është e pamjaftueshme, pasi inceneratori i Tiranës është për të gjithë qarkun e Tiranës, thotë KLSH-ja. Dokumentet që ato kanë këshilluar, Bashkia e Tiranës, edhe kjo sipas ligjit në fuqi, ka qenë dakord për këtë incenerator, por nuk është

shprehur këshilli bashkiak i Tiranës. Kujtojmë që këshilli bashkiak i Tiranës është përgjegjës edhe për çështjen e pronës. Çdo vendim pronësor që merret për transferim prone dhe për dhënie me koncesion duhet të kalojë në këshillin bashkiak të Tiranës, duhet të kalojë edhe me shumicë të cilësuar. Nuk e di, a e ka kaluar këtë kryetari i bashkisë në këshillin bashkiak të Tiranës? Ai i ka tejkalar kompetencat e tij? A ka marrë rolin sa i takon këshillit bashkiak të Tiranës?

KLSH-ja vëren se edhe në rastin e dakordësisë së Tiranës përsëri s'e kanë ndjekur rrugën ligjore, sepse duhej të ishte mbledhur këshilli bashkiak i Tiranës, thotë Kontrolli i Lartë i Shtetit, për të dhënë mendimin, faqja 19 e këtij raporti që unë citova, për tavanet buxhetore, sepse janë angazhuar për 430 milionë euro për 90 vjetët në vijim. Këtu kemi një cenim të autonomisë vendore për sa i përket bashkive të tjera të qarkut Tiranë.

Projekti i PPP-së ka parashikuar një pagesë prej 7,4 milionë euro pa TVSH përmes detyrimit minimal për Bashkinë Tiranë, 700 tonë mbetje në ditë, që shkon në total 222 milionë euro. A ju kujtohet kërkesa prej 90 milionë eurosh, që Ministria e Mjedisit tha se i kushton ky incinerator buxhetit të shtetit?! Ajo shkoi 222 milionë euro, thotë Kontrolli i Lartë i Shtetit, pa TVSH.

Risku i dytë. Një sjellje e tillë, thotë Kontrolli i Lartë i Shtetit, i shton risqet në buxhetin qendror dhe vendor, sepse këto fonde nuk ekzistojnë, nuk janë të parashikuara në asnjë buxhet, as në planin buxhetor afatmesëm, as në buxhetet vjetore, minimumi. KLSH-ja ka konstatuar se kur është miratuar ky plan buxheti i shtetit nuk i ka pasur këto fonde. Pra, është buxhetuar për një shumë që nuk ekziston në buxhetin e shtetit. Kjo është një shkelje në ligjin e menaxhimit të shpenzimeve buxhetore, që sot është në zbatim nga Ministria e Financave, por, njëkohësisht, edhe nga pushteti lokal.

Me fjalë të tjera, Ministria e Mjedisit e ka siguruar, prandaj jua tregova historikun e shkresave, gjatë gjithë kohës së operimit të miratimit të procedurës koncesionare, që këto fonde ekzistojnë, që kushtojnë 90 milionë euro, ndërkohë që fondet nuk ekzistojnë, thotë Kontrolli i Lartë i Shtetit, dhe nuk ka pasur asnjë dokument formale që të ishin miratuar me një letër zyrtare shteti 430 milionë euro që kushton ky koncesion. Për më tepër, ndërhyne edhe në autonominë vendore dhe thotë se do të paguhet me grantin e pakushtëzuar, granti i kushtëzuar i bashkive shkon për paga dhe këtu, Kontrolli i Lartë i Shtetit, e konsideron si shkelje. Granti i kushtëzuar shkon për paga, por edhe grantin e pakushtëzuar, që mund të bëjnë ndonjë investim bashkitë, ua

kushtëzojnë bashkive dhe thonë që çojeni tek inceneratori. Ky është përsëri një cenim i autonomisë vendore.

Duke qenë se parashikimet janë fiktive (a ju kujtohet që Ministria e Mjedisit thoshte që bëhet 29 euro për ton mbetje kosto e administrimit në inceneratorit e Tiranës?) Kontrolli i Lartë i Shtetit thotë se duke qenë se kostot janë fiktive, janë të gënjeshtërt, pas analizës dhe studimit del që kostot reale për ton nuk janë 29 euro për ton, por sot, administrimi në inceneratorin e Tiranës i kushton buxhetit të shtetit 40 euro për ton. Pse?! Kostot po jua rendis tani. Inceneratori i Tiranës do të ketë përfitime edhe për energjinë edhe për shitjen e energjisë 133 milionë euro me 70 euro për megavat, por njëkohësisht, nuk disponohet asnjë evidencë që justifikon aplikimin e shitjes me 70 euro për megavat. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës nuk ka pasur një me Entin Rregullator për miratimin e kësaj procedurë, nuk ka pasur komunikim as me entin që miraton politikën, si dhe nuk ka pasur asnjë procedurë formale të miratimit të kësaj. Ministri Gjyknuri kur të vijë këtu duhet të na jap përgjigje.

Në lidhje me sa më sipër, arrihet në konkluzion se projekti koncesionar nuk është kundërshtuar nga Ministria e Financave, edhe në fund, megjithëse është miratuar i tillë. Ministria e Financave duhej ta kishte ndaluar këtë. Bonusi ka kaluar në Këshillin e Ministrave, kështu që ka pasur mundësinë ta ndalonte këtë procedurë dhe nuk e ka ndaluar, është mjaftuar vetëm me dërgimin e disa shkresave, dhe në fund, kur është miratuar koncesioni, e ka marrë të mirëqenë këtë. Është përgjegjësi e Ministrisë së Financave firmosja e kësaj kontrate koncesionare dhe risku që ajo mban, sepse kanë implikim të drejtpërdrejtë në buxhetin e shtetit. Ju kujtoj detyrimin ligjor që ka Ministria e Financave, e cila duhet të japë dakordësinë paraprake, financiare, për çdo kontratë koncesionare që është brenda tavanit buxhetor.

Diferencat e paraqitura në investimet e propozuara për mjetet e transportit, thotë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, kanë një diferencë që nuk është raportuar saktë dhe gjejnë një shkelje, për këtë arsye kostoja është më e lartë. Kontrolli i Lartë i Shtetit thotë se vetëm shpenzimet për transportin janë 58 milionë euro. Pra, kostoja reale e inceneratorit është edhe 58 milionë euro më shumë, se 222 milionë euro që komunikova pak më përpara.

Të gjitha këto kosto, duke shtuar pjesën e energjisë, duke shtuar pjesën e çmimit, duke shtuar pjesën e riskut të inflacionit dhe riskun e kursit të këmbimit, që Kontrolli i Lartë i Shtetit riskun e kursit të këmbimit dhe të inflacionin e ka llogaritur me 78 milionë euro, kostoja për ton mbetje, reale, sot, në inceneratorin e Sharrës është 40 euro për ton mbetje.

Qeveria shqiptare ka gënjyer. Bashkia e Tiranës ka gënjyer. Ministria e Mjedisit ka gënjyer. Ministria e Financave ka gënjyer. Kostoja që ne paguajmë sot në Sharrë është 40 euro për ton.

Pavarësisht gjithë këtyre problemeve metodologjike, pavarësisht se kostoja u rrit, kostoja totale e këtij projekti, thotë Kontrolli i Lartë i Shtetit, e provuar dhe e dokumentuar, duke shtuar të gjitha këto që unë përmenda, shkon në 430 milionë euro. Këtu ka përgjegjësi ministri Arben Ahmetaj dhe ish-ministri Lefter Koka, për miratimin e këtij projekti, si dhe për faktin që kanë miratuar një kontratë koncesionare, e cila ia ka transferuar të gjitha risqet shtetit dhe asnjë risk koncesionarit.

Dua të ndalem edhe te një element i fundit, përpara se t'ia jap fjalën zonjës Zhupa. Pjesë e anekseve të kontratës koncesionare, megjithëse kanë hequr shumë dokumente, ne kemi arritur të gjejmë një pjesë të tyre, një pjesë sigurisht që mungojnë, është edhe grafiku i punimeve. Sot komisioni hetimor ka parashikuar të shkojë tek inceneratori i Tiranës, por për mua është e kotë. Unë kam qenë një herë atje, zoti Këlliçi ka qenë, zonja Zhupa ka qenë, ishte e kotë, por qeveria po insiston.

Ndërkohë, pyetjet e mia sot janë: loti i parë i incenerimit, a ka përfunduar në dhjetor të vitit 2019? A është fizikisht aty që në dhjetor të vitit 2019, meqenëse e ka marrë pagesën, siç thotë kontrata koncesionare?

Loti i dytë i punimeve të incenerimit të mbetjeve, a ka shkuar 6 muaj më pas?

Loti i tretë i punimeve, a ka shkuar në dhjetor të 2019-s?

Loti i katërt, e kështu më radhë, çfarë po ndodh sot me inceneratorin e Tiranës? A kemi një kodër të mbushur me akacie, të lyer me bojë, të bojatisur, siç dinë këta të bëjnë? A kemi sot një landfill, që kryen vetëm procesin e landfill-it apo kemi sot një incenerim të plotë me të 9 lotet fizikisht, atje, me impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura, atje, fizikisht, siç thotë grafiku i punimeve, me të gjitha elementet e incenerimit, atje, siç thotë grafiku i punimeve? Jemi në shkurt të vitit 2022, a ndodhen fizikisht të gjitha këto elemente që unë përmenda? Por përpara se të shkojmë atje, zonja Zhupa do t'i japë përgjigje Kontrollit Lartë të Shtetit, për performancën, se çfarë ka gjetur atje, kur ka shkuar 1 muaj më parë.

Zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë do të mundohem të jem përmbledhëse në gjërat që do të them. Që nga momenti i parë, ju e kujtoni, sesi zonja ish-ministre, atëherë, thoshte se kompania nuk ishte e regjistruar në QKB. Kompania Integrated Energy e regjistroi veten si kompani në Tiranë, më pas, në gusht të vitit 2017, me një kapital themeltar prej 100 mijë lekësh të rinj, pra rreth 800 euro. Kjo ishte kompania e krijuar posaçërisht për menaxhimin dhe për marrjen e kontratës së koncesionit. Pra, një kompani që do të merrte miliona euro kishte kapital, dhe e krijoi atë mbasi diskutohej dhe në shkresën e zonjës Felaj, 800 euro.

Dhe në vitin 2018, në vitin e parë të saj të operimit, kur realizoi sipas të dhënave nga Thesari 9,6 milionë euro të ardhura, kapitali i saj dhe i aksionerëve vijoi të mbetet 800 euro në bilancin e dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Kjo, për të kuptuar se çfarë ndodh me këtë kompani, me këtë koncesion, që ka mbrojtje shtetërore, edhe pse pronarët sot i ka në kërkim ndërkombëtar.

Më 31 gusht, siç e thatë ju, është lidhur kontrata koncesionare ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë Integrated Energy. Çfarë ndodh? Në datën 21 qershor 2018 Agjencia Kombëtare e Mjedisit me aktin nr. 5321 i ka refuzuar pajisjen me lejen mjedisore kompanisë që ka marrë koncesionin, ndërkohë kompania nuk merr asnjë gjobë, nuk ndalon punimet, vazhdon, sepse ka mbrojtje shtetërore. Sërish, kompania ka aplikuar edhe më 16 janar 2020, por Agjencia Kombëtare e Mjedisit e ka refuzuar sërish lejen mjedisore, duke u shprehur me aktin nr. 498.

Në datën 19 korrik 2021, kompania ka arritur, më në fund, pra në vitin 2021 (të kemi parasysh që kontrata është firmosur në gusht të vitit 2017), të marrë lejen mjedisore, sipas aktit me nr. 5879, numër protokolli. Ndërkohë, sipas VKM-së nr. 811, datë 26.12.2018 dhe VKM-së nr. 1154, datë 24.12.2020, qeveria u kujtua dhe vendosi të shpronësonte tokat e banorëve të Sharrës për llogari të koncesionit të trajtimit të mbetjeve për 448 lekë metri. Banorët e kundërshtuan këtë shpronësim dhe u ngritën në protesta në maj të vitit 2019. Pra, ndërkohë që ishte fakt i kryer, kujtohen të bëjnë edhe VKM-të për shpronësimet për banorët e Sharrës.

Inceneratori ndërkohë, siç tha edhe zonja Tabaku, ka filluar dhe i ka marrë paratë që më përpara, që sa nisi. Pra, brenda natës, duhet të kujtojmë qytetarët, që landfilli i Sharrës ekzistonte dhe ishte në funksion për mbetjet e qytetit dhe brenda natës, nga një shërbim publik i bashkisë së Tiranës u kthye në një monopol privat. Ajo që ndryshoi, se nuk ndryshoi kushtet, nuk filloi inceneratori, ishte fillimi i pagesave. Pra, banorët e Tiranës, qytetarët e Tiranës, filluan të

paguanin diçka që nuk e merrnin, pra paguanin atë që e kishin pasur, që edhe sot do të shkojmë do ta shikojmë që do të jetë e njëjta skemë ku atje nuk kryhet asnjë incenerim.

Që në vitin e parë i kanë paguar 5,8 milionë euro dhe kanë vendosur edhe në kontratë që minimalisht 650 tonë në ditë duhet t'ia japin koncesionit nga bashkia e Tiranës. Kompania Integrated Energy BV SPV, sipas pikës 5,8 të kontratës, brenda 8 muajve duhej të merrte lejen zhvillimore, të çonte projektin, të plotësonte kriteret dhe të merrte lejen zhvillimore, lejen e ndërtimit, për të ndërtuar atje impiantin, objektin që do të bënte incenerimin. Vërtetohet nga aktet zyrtare që është pajisur me leje ndërtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit, me vendim nr. 14, më 17 maj 2019, me firmën e zonjës Balluku dhe zotit Rama. Pra, më 17 maj 2019 është miratuar leja zhvillimore, ndërkohë që ka pasur shkelje të kontratës, të detyrimit kontraktor, se lejen duhet ta kishte marrë për 8 muaj, ndërkohë kishin 2 vjet që bënë pranime mbetjesh, gproposje mbetjesh, pasi nuk kishin marrë as lejen për të ndërtuar inceneratorin, por lekët i merrnin sikur të ishte inceneratorit i Tiranës.

Sot ne do të shkojmë atje dhe sigurisht edhe me kamera, që të shikojmë këtë që ne themi, sepse impianti nuk ekziston. Zhvillimi i punimeve sipas lejes së ndërtimit nuk ka ndodhur kurrë. Koncesionari atje ka ndërtuar, dhe ne do t'i shikojmë, disa vaska mbetjesh me kosto tepër të ulët, të cilat nuk i përgjigjen as kontratës dhe as detyrimit kontraktor që ajo ka.

Bazuar në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 40, që është Afati i lejes së ndërtimit, thotë: “Afati për fillimin e punimeve të një lejeje ndërtimi nuk mund të jetë më i gjatë sesa 1 vit nga data e miratimit të lejes”, ndërkohë leja është dhënë 2 vjet më parë dhe ende sot nuk ka filluar punimi, dhe nuk dihet kur do të fillojë incenerimi.

Bashkia e Tiranës, është e rëndësishme të thuhet, se kur themi “bashkia Tiranë”, kemi parasysh qytetarët e Tiranës, sepse paratë që paguan bashkia Tiranë apo qeveria janë të qytetarëve, koston e pastrimit të qytetit para kontratës koncesionare e kishte 1,16 milionë, për periudhën 2015-2017, me kontrata të nënshkruara nga Erjon Veliaj.

Gjithashtu, për vitet që kemi inceneratorin, që nuk e kemi, kostoja mesatare vjetore e pastrimit kaloi në 1,28 miliardë lekë dhe ajo e menaxhimit të inceneratorëve në 3,23 miliardë lekë, duke e çuar vlerën mesatare në periudhën 2018- 2020 në 2,36 miliardë lekë. Pra, kemi dyfishim të shpenzime që jepen nga buxheti i shtetit, nga paratë e taksapaguesve për një gjë që ende nuk ndodh, për një proces që nuk ndodh. Pra, për të njëjtin proces që ndodhte para se ta

kishim koncesionin, ne paguajmë më shtrenjtë tani, për një gjë që është e njëjta gjë. Domethënë, nuk ndodh asgjë e re nga ajo që duhet ndodhte sipas kontratës.

Ndërkohë, bashkia Tiranë ka edhe marrëdhënie të tjera me kompanitë ALB- IMPEX, Fusha sh.p.k., Korsel sh.p.k., Ante grup, Eco Tirana, që lidhen me kontratat koncesionare të pastrimit, përsëri kosto që i paguajnë qytetarët e Tiranës.

Për ta pasuruar edhe më shumë inceneratorin e Tiranës, mbas asaj që tha kryetarja e komisionit, zonja Tabaku, u bë marrëveshja me bashkinë e Durrësit me atë, që ju doni ta promovoni si pjesë e grupit të strukturuar kriminal, nënkryetaren e bashkisë së Durrësit. Nuk lanë pa futur në këtë vorbull edhe bashkinë Kavajë. Këshilli bashkiak shpall edhe aty emergjencë, merr vendim me nr. 57, ku vendos të miratojë një marrëveshje mes bashkisë Kavajë dhe inceneratorit të Tiranës, të miratojë edhe ndryshimet në buxhet, të planifikojë edhe fonde për këtë marrëveshje. Prefektura e qarkut Tiranë, me shkesë nr. 1115/1, i përgjigjet bashkisë Kavajë, që vendimi nr. 57, nuk është ligjërishit i vlefshëm, sipas prefektit Mersin Murataj. Këto janë shkresa zyrtare që i keni shkëmbyer me njëri-tjetrin.

Sipas programit të auditimit të performancës, Eurostat-i e rendit Shqipërinë të tretën (ne zakonisht jemi të fundit në gjërat e mira e rendit) në listën e atyre pak vendeve europiane që përdorin metodën e incenerimit për përpunimin e plehrave, mbas Gjermanisë dhe Sllovenisë. Shqipëria, po sipas Eurostat-it, ka nivelin më të ulët të mbetjeve për frymë në Europë dhe ngrihet pikëpyetja që lidhet me investimin në fjalë dhe me domosdoshmërinë e tij. Shqipëria duke ngritur inceneratorët ka kundërshtuar Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve, si dhe objektivat që vetë i kishte vendosur vetes në këtë strategji, duke vendosur riciklimin në 55% të preferencave për mbetjet në vend. Këto janë gjetje të programit të auditimit të performancës.

Do më falni, se mos duket sikur qajmë hallet tuaja, por po qajmë vetëm hallet e buxhetit të shtetit dhe interesit publik.

Njësia e zbatimit të projektit është krijuar disa muaj mbas datës efektive dhe sipas KLSH-së njësia e zbatimit të projektit nuk është e plotë. Pas dorëheqjes së përfaqësuesit të Ministrisë të Mjedisit dhe Turizmit, autoriteti kontraktor nga viti 2017 ka kaluar nga Ministria e Mjedisit, te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, më tej te bashkia Tiranë dhe është përgjegjës për monitorimin dhe rakordimin e sasive të depozituara të mbetjeve urbane. Fokusi i Ministrisë së Mjedisit është vendosur tek incenerimi si proces, ndonëse sipas të dhënave nuk ka asnjë progres në fushën e riciklimit, që e kishin vendosur vetë si metodë të preferueshme.

Kjo zhvendosje sigurisht që ka lidhje me të gjithë atë që ne parashtruam. Nuk është zhvendosje thjesht sepse bënë studim dhe ndërruan mendim, por është zhvendosje sepse luajnë miliona euro në firma, që nuk dihet se ku i kanë zyrat, në firma që kanë kapital të deklaruar 800 euro, në pronarë që sot janë në kërkim ndërkombëtar.

Ndërkohë, Ministria e Mjedisit dhe e Turizmit duhet të emërojë një anëtar për njësinë e zbatimit të projektit, sipas raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Për periudhën e auditimit të koncesioneve të dhënat në sektorin e mjedisit llogariten në vlerën 41 miliardë lekë, ku investimi i inceneratorit të Tiranës kap vlerën 141,74 milionë euro. Pra 41,2% të kontratave koncesionare në fushën e mjedisit për periudhën 2014-2018 dhe 24,4% të vlerës së koncesioneve të inceneratorëve vetëm për vitin 2018. Shifrat janë të rëndësishme, që qytetarët të kuptojnë se për çfarë abuzimi milionaeurosh bëhet fjalë.

Nëse do të krahasoheshin këto të dhëna me treguesit fiskalë për produktin e brendshëm bruto të secilit vit, pasqyrohet një trend rritës i koncesioneve në fushën e mjedisit dhe nga viti 2016, që zë 0,3% të produktit të brendshëm bruto, në vitin 2018 zë 1,04% të produktit të brendshëm bruto. Sipas tabelave, taksat e qytetarëve të Tiranës, atë që jua përmenda, ua tha edhe zonja Tabaku me shifra, u dyfishuan dhe banorët e Tiranës paguajnë si taksë pastrimi përsëri më shumë, por paguajnë edhe taksa kur shkojnë nga buxheti i shtetit te bashkia e Tiranës, si pagesa për inceneratorët. Pra, e paguajnë dy herë këtë inceneratorin, që nuk ekziston, në landfillin e Sharrës.

Për ta mbyllur, në mënyrë të tillë që të kemi mundësi ta shikojmë nga afër, vetë koncesionari, sipas KLSH-së, paraqet probleme dhe vështirësi financiare në përmbushjen e detyrimeve të kontratës. Sipas planit të biznesit të paraqitur, shihet se ai ka marrë një kredi bankare dhe për këtë ka informuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës, autoritetin kontraktor, duke e vënë në dijeni se ka dy kredi afatgjata dhe afatmesme për vijimin e projektit, ndërkohë i ka marrë të gjitha pagesat nga buxheti i shtetit nga Ministri e Financave. Kjo gjë bie në kundërshtim me planin e biznesit të shoqërisë, që është zotuar dhe ka deklaruar se ajo ka kapital financiar për të kryer investimin, ndonëse nuk siguron se sa këto janë prej të ardhurave të siguruara nga operimi dhe sa nga të ardhurat e marra nga buxheti i shtetit, pra që s'ka nevojë për financim shtesë.

Këto që sapo ju citova janë të gjitha akte zyrtare dhe shkresa zyrtare, që vijnë nga qeveria juaj, nga sistemi shtetëror, pra nga raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Faleminderit!

Jorida Tabaku - Faleminderit!

Për ta përmbledhur, sipas kontratës koncesionare, që unë ju prezantova, grafiku i punimeve thoshte që duhet të kishin ardhur të nënta lotet e incenerimit në inceneratorin e Tiranës. Investitori duhet të kishte paguar të gjithë vlerën e investimit, ndërkohë që investitori ka paguar vetëm 31%. Nuk është zbatuar në kontratë çështja e penalteteve dhe ashtu siç vërteton raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit, pajisjet nuk kanë ardhur. Kemi paguar një tarifë incenerimi për pajisje incenerimi, të cilat nuk kanë qenë atje.

Ajo që harrova të përmend në raportin e gjatë të fakteve dhe shkeljeve për inceneratorin e Tiranës, është një fakt shumë i rëndësishëm. Në çdo kontratë normale të shtetit shqiptar, në kontrata firmoset dhe miratohet një skedul pagesash në varësi të skedulit të punimeve. Pra, kryhet një transh punimesh, miratohet nga supervizori, shkon tek autoriteti kontraktues, miratohet pagesa. Por të tria kontratat koncesionare të inceneratorëve Tiranë, Elbasan dhe Fier janë unike, e fillojnë pagesën ditën e firmosjes së kontratës. Ky është problemi kryesor, që ka ndodhur me këto 3 kontrata koncesionare, sepse të tria kanë marrë paratë, përveç procedurës abuzive, përveç procedurës në shkelje, përveç rritjes së kostos, përveç vjedhjes, përveç çdo gjëje që ne prezantuam këtu, kanë marrë paratë dhe nuk kanë kryer punën.

Detyra e këtij komisioni hetimor është të gjejmë cilët janë pronarët përfitues. Ndër pronarët përfitues në inceneratorin e Elbasanit ishte zoti Lefter Koka, është zoti Alqi Bllako.

Cilët janë pronarët përfitues të 430 milionë eurove? Ku kanë shkuar 430 milionë euro, dhënë me procedurë korruptive për inceneratorin e Tiranës?

Unë besoj që qytetarët shqiptarë këto ditët e fundit po dëgjojnë shumë, por nuk ka asnjë show medietik dhe nuk ka asnjë mbrojtje ligjore që e mbulon vjedhjen e 430 milionë eurove! Asgjë, as boja, as akacia, absolutisht asgjë, nuk e mbulon këtë aferë korruptive!

Madje, dua t'u kujtoj të gjithëve se si nisi kjo. Kjo nisi me tre kallëzime penale të Partisë Demokratike në SPAK për një grup të strukturuar kriminal për inceneratorin e Elbasanit, për inceneratorin e Fierit dhe për inceneratorin e Tiranës. SPAK-u na dha të drejtë për inceneratorin e Elbasanit.

Dy pikat e para të njoftimit të SPAK-ut ishin për padinë penale që ne kemi dorëzuar, për kallëzimin penal që ne kemi dorëzuar, për sa u përket procedurave.

Unë shpresoj shumë të vazhdojnë me Fierin dhe ajo që është më e rëndësishmja shpresoj shumë të vazhdojnë me Tiranën, sepse grupi i strukturuar kriminal ka vepruar në operativitet të plotë tek inceneratori i Tiranës.

Ashtu siç unë i prezantova sot faktet, ashtu siç qytetarët i dëgjuan për vendimmarrjen shtetërore, për mbrojtjen politike, për avokatinë juridike që po u bëhet këtyre koncesionarëve sot, unë besoj që ky parlament, ky komision hetimor, çdo deputet që guxon dhe mbron vjedhjen dhe korrupsionin, duhet të mbajë përgjegjësi përpara atyre që i kanë votuar.

Ky ishte prezantimi nga ana e opozitës.

Kush do të prezantojë nga ana e maxhorancës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të flisni me radhë? Do të flisni ju, zonja Felaj? Dua t'ju kujtoj konfliktin e interesit.

Zonja Felaj, keni qenë e përfshirë në vendimmarrjen për inceneratorin e Tiranës.

Zonja Felaj asokohe ka qenë ministre Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin. Zoti Lefter Koka i ka dërguar një shkresë zonjës Felaj për ta pyetur për procedurën koncesionare. Zonja Felaj ka ngritur disa shqetësime, që, në fakt, janë të drejta, si: “Kompania nuk është regjistruar në QKB”, “Nuk duhet miratuar bonusi, - thotë, - me vendim të Këshillit të Ministrave”; “duhet të ketë një studim fizibiliteti”; “nuk duhet të ketë mbivendosje me projektin e JICA-s”. Papritur, shefja e kabinetit të zonjës Felaj, zonja Rovena Voda, ka ndryshuar mendim dhe i ka dhënë një përgjigje me *email* zotit Alqi Bllako, duke i thënë që edhe zonja Felaj është dakord me këtë procedurë koncesionare.

Unë jam ligjvënëse, në fakt, nuk jam juriste, por, po të isha juriste, nuk do të kisha folur, sepse ka një konflikt interesi. Prandaj, e theksoj edhe një herë, është shumë e rëndësishme, kolegë, të mos i bëjmë avokati politike dhe juridike vjedhjes!

Zonja Felaj, ju pyes edhe një herë, do të flisni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Veten paçi më qafë!

Ermonela Felaj – ...nuk ka nevojë të më bëni ju moral, aq më tepër duke mos pasur as formimin e juristit, të kërkoni e të guxoni dhe të kuptoni ligjin apo edhe ta citoni atë. Megjithatë, unë nuk do të merrem me kulturën tuaj juridike, as të askujt, sepse kjo nuk është fare pjesë e shqetësimit tonë.

(Kryetarja e komisionit ndërhyr pa mikrofon.)

Të lutem tani, se të dëgjova për një orë e një çerek...

(Kryetarja e komisionit ndërhyr pa mikrofon.)

...kështu që përpiqu ta ruash qetësinë dhe të dëgjosh po aq!

(Kryetarja e komisionit ndërhyr pa mikrofon.)

Epo mirë, kur je, mos u hidh përpjetë, se nuk ka kuptim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, me qytetari, por me qytetari do të thotë që ti të dëgjosh, se prandaj ju dëgjuam me qetësi!

Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve ka qenë dhe mbetet një sfidë për shtetin shqiptar, ama diferenca nga viti 2013 dhe këtej është që nga atëherë, kur nuk bëhej asgjë, ka një hop cilësor në drejtim të përgatitjes dhe ndjekjes së atyre rrugëve të rëndësishme që sigurojnë trajtimin adekuat të të gjitha mbetjeve që krijohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Strategjia kombëtare orienton për një politikë kombëtare të mbështetur në katër shtylla: në planifikim, në edukim, te burimet dhe te legjislacioni.

Pra, të planifikosh do të thotë se cilat do të jenë rajonet ku do të zbatohet trajtimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve. Aktualisht, Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve parashikon që trajtimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve të bëhet në 10 rajone të Shqipërisë. Pra, ndarja është rajonale, sipas planit që ka bërë institucioni qendror.

Edukimi nuk është një sfidë të cilën ne e kemi arritur, dhe për këtë jemi koshientë të gjithë, kultura e të gjithëve në drejtim të krijimit të sa më pak mbetjeve apo të diferencimit të mbetjeve është një kulturë e munguar në Shqipëri. Dhe këtë nuk ka asgjë që e kundërshton, sepse fakti është evident.

Në fund të ditës ne jemi qytetarë dhe e dimë shumë mirë se sa mbetje krijojmë çdo ditë në shtëpitë tona.

Po të marrësh të dhënat e INSTAT-it, rezulton që çdo person krijon 1,4 kilogramë mbetje çdo ditë dhe, po t'i shumëzosh këto me numrin e qytetarëve shqiptarë aktualisht në vendin tonë, atëherë merret me mend se sa e madhe është sasia e mbetjeve që krijohen çdo ditë dhe se çfarë angazhimi serioz kërkon që këto mbetje t'i menaxhosh në mënyrën e duhur.

Burimet janë kapacitete njerëzore, janë edhe burime financiare. Procesi i menaxhimit të mbetjeve është një proces që kushton. Në të gjithë botën kushton. Nuk është një proces i lehtë për t'u bërë dhe për t'u ndërmarrë ashtu siç duhet, se, po t'i hidhje, siç ndodhte deri në vitin

2013, 50% në kosh dhe 50% lumenjve, deteve, rrugëve e të tjera e të tjera me radhë, sigurisht që nuk do të kushtojë historia.

Kapacitetet njerëzore janë, po ashtu, të rëndësishme.

Ndoshta publiku na ka ndjekur realisht këto ditë dhe shpresoj të na ketë ndjekur për aq sa ia vlen ta ndjekësh këtë çështje, ama asnjëri nga ne këtu nuk është ekspert mjedisor. Për fat të keq, nuk kemi dëgjuar asnjë ekspert mjedisor të flasë për këtë çështje, ndërkohë që kemi bërë gjithfarë rolesh: kemi bërë si prokurorë, kemi bërë si gjyqtarë, kemi bërë si policë, kemi bërë si ekspertë të kësaj e të asaj, cilësi, në fakt, që nuk i gëzojmë.

Të vijmë te legjislacioni dhe kjo është pika, në fakt, ku realisht është bërë progres, sepse, edhe pse në rastet që ne po diskutojmë, është vepruar kryesisht mbi një legjislacion mbi të cilin ka vepruar edhe qeverisja juaj, rrugës legjislacioni është përmirësuar. Ndoshta kjo nuk është vetëm meritë e qeverisjes sonë, por është edhe fakti që vetë Bashkimi European ka orientuar direktiva të ndryshme në fushë dhe për këtë arsye është dashur që legjislacioni të ndryshohet.

Do t'i referohem ligjit "Për koncesionet" ose ligjit "Për partneritetet publike-private". Dy nga gjërat e rëndësishme që kanë ndryshuar në atë ligj, dhe këto i ka bërë qeveria jonë, janë si më poshtë.

Së pari, nuk ka më propozim të pakërkuar për projekte të tilla, për projekte të trajtimit dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve. Kjo është hequr në ligj që prej vitit 2019.

Së dyti, nuk jepet më bonus për propozimin e pakërkuar.

Së treti, kjo është zëvendësuar me kompensim, që shkon deri në 1% të vlerës së investimit.

Do t'ju ftoja ta lexonit ligjin, sepse në vend të pyetjeve retorike të pafundme, që, për shkak të natyrës, nuk presin dhe nuk marrin përgjigje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...do të thotë që gjithsekush që pret përgjigje dhe argument, do të duhet ta lexojë ligjin dhe të kuptojë nëse është apo jo kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të vijmë tani te landfilli i Tiranës. Sipas një shkrese...

(Deputeti Spaho flet pa mikrofon.)

Ju lutem, a mund të mbani qetësi, se ju dëgjuam? Ju dëgjuam!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por nuk e kemi lënë...

Shikoni, ju lutem, nuk e kemi lënë në vlerësimin tuaj seriozitetin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Dhima – A foli njeri, kur foli Jorida...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Pse jemi seriozë, pse nuk ju dukemi seriozë, kjo është çështje e gustos tuaj!

Në Kuvendin e Shqipërisë nga ky komision hetimor është administruar një përgjigje e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përmes së cilës na bëhet me dije që landfilli i Sharrës, që mbulon vetëm Bashkinë e Tiranës, e theksoj vetëm Bashkinë e Tiranës, jo qarkun e Tiranës, i ndërtuar në periudhën 2006-2008 dhe i planifikuar për të operuar deri në vitin 2015, administrohet nga Bashkia Tiranë.

Tani, e dhëna që ky landfill ishte ndërtuar për të operuar deri në vitin 2015, justifikon edhe arsyen pse në vitin 2015 Bashkia Tiranë, që është autoritet përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve të qytetit të Tiranës, në pajtim kjo me Planifikimin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, më 23.12.2015 i drejtohet ministrit të Mjedisit (se është ministria që e ka në fushën e saj të veprimit dhe e ka përgjegjësi menaxhimin e mbetjeve në Republikën e Shqipërisë) që ta asistojë për përfshirjen e sektorit privat në procesin e menaxhimit të mbetjeve në qytetin e Tiranës, kjo sipas studimeve të IFC-së, nëpërmjet partneritetit publik-privat, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve.

Për hir të së vërtetës, edhe kur Bashkinë e Tiranës e ka drejtuar kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka pasur studime të ngjashme që tregonin se bashkia nuk kishte kapacitete intelektuale dhe as kapacitete financiare që ta merrte përsipër pastrimin e mbetjeve në qytetin e Tiranës, por nevojitej një partneritet publik-privat.

A mori kjo shkresë përgjigje të menjëhershme? A u zgjidh të nesërmen historia e mbetjeve të Tiranës? Jo, nuk u zgjidh dot të nesërmen, se, në fakt, nga komunikimet shkresore rezultoi që vetëm në datën 23.06.2016, pra një vit më pas, Ministrisë së Mjedisit i ka shkuar një propozim i pakërkuar nga një bashki operatorësh.

Unë nuk do të merrem me operatorët privatë, sepse, e thashë edhe një herë, nuk është ky objekt i punës së komisionit. Ne hetojmë sjelljen e institucioneve shtetërore në raport me këtë çështje, nuk hetojmë sjelljen e privatëve se si i ndërtojnë ata shoqëritë, ku i ndërtojnë... Nëse

bëjnë shkelje të tilla, padyshim që organet e drejtësisë e kanë detyrimin dhe të gjithë të drejtën, sepse ua jep ligji, që t'i ndjekin dhe t'i sanksionojnë.

Bashkia Tiranë, në qershor të vitit 2016, menjëherë pasi Ministria e Mjedisit njofton se ka një propozim të pakërkuar, i bën me dije situatën në vend-depozitim të Sharrës. Unë besoj se për publikun mbeten ende në kujtesë emisione të tëra televizive, ku shfaqej mali shkruar në Sharrë dhe historia e njerëzve, të cilët kanë humbur jetën, për shkak se shkonin aty për të mbledhur mbetje nga ato që riciklohen, seleksionohen e të tjera me radhë.

Çfarë rezultonte në Sharrë deri në vitin 2015, kur Sharra, në fakt, e mbaroi funksionimin e vet? Patjetër që duhej një zgjidhje, se e mbaroi landfilli. Ku t'i çonin plehrat e Tiranës?

Atëherë, në Sharrë vetëm për vitin 2015 sasia totale e mbetjeve të depozituara, edhe një herë, nga Bashkia Tiranë (që do të thotë se atje nuk depozitonte as Kamza, as Vora, as Kavaja, as Durrësi, por vetëm Tirana) ishte 200 mijë 275,2 tonë mbetje dhe Tirana, sipas censurit të 1 janarit të vitit 2016, kishte vetëm 780531 qytetarë.

Në qoftë se bëni një veprim të thjeshtë matematikor, sigurisht, do ta kuptoni se sa e lartë ishte sasia e mbetjeve për çdo qytetar që jeton në Tiranë.

Menjëherë pas kësaj, autoriteti kontraktor, autoriteti përgjegjës (Ministria e Mjedisit), sigurisht është marrë me operatorin, i cili ka kërkuar dhe ka bërë propozimin të merrte përsipër trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë e Tiranës, procedura është ajo që parashikon ligji, në kuptimin që është kërkuar të ngrihet komisioni i dhënies me koncesion. E kemi thënë edhe gjatë ditëve të mëparshme që vetë ligji “Për koncesionet” orienton që për trajtimin e menaxhimit të mbetjeve të përdoret koncesionimi, që, gjithashtu, është e qartë. Ndërkohë ngrihet komisioni i koncesionit me përfaqësues të ATRAKO-s, me përfaqësues të bashkisë, me përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Ngritja e komisionit ka përfunduar diku nga shtatori i vitit 2016, sigurisht ka zhvilluar mbledhje dhe është marrë me të gjitha detyrimet që i ngarkon ligji për përgatitjen, sigurimin e dokumentacionit.

Vijmë te Këshilli i Ministrave. Këshilli i Ministrave ka marrë dy vendime në lidhje me këtë procedurë. Vendimi i parë është ai që ka të bëjë me miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë “Për dhënie me koncesion për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim të vend-depozitimeve ekzistuese, Tiranë”. Edhe nga titulli i këtij vendimi del e qartë që do të bëhej rehabilitimi i vendit, natyrisht do të vazhdohej të përdorej si landfill dhe më tej akoma do t'i shtohej edhe incenerimi.

Madje, për t'i dhënë fund njëherë e mirë diskutimit se “A duhet apo nuk duhet incenerimi, a e kishte parashikuar apo jo shteti shqiptar incenerimin dhe çfarë është incenerimi?”, unë ju ftoj të gjithëve ta lexoni ligjin e vitit 2011, kur në qeverisje ishte Partia Demokratike, i cili e ka përkufizuar në nenin 3 të tij, incenerimin, si një nga metodat për trajtimin dhe menaxhimin e mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Besoj se kjo gjë do t'u japë fund njëherë e mirë debateve sikur incenerimin e sollëm ne, e shpikëm ne, ndërkohë që incenerimi ka qenë i njohur që në vitin 2011 dhe ligji orientonte për zbatimin e incenerimit në trajtimin e mbetjeve.

Pse është dhënë bonus? E detyron ligji “Për koncesionet” dhënien e bonusit dhe këtë vendim ka marrë qeveria, duke iu përgjigjur ligjit. E deri këtu, mirë apo keq, na pëlqen apo nuk na pëlqen ligji, sa kohë është e shkruar në ligj, sjellja e organeve shtetërore është e legjitimuar, sepse është e mbështetur në ligj.

Cili ka qenë vendimi tjetër që ka marrë qeveria në lidhje me këtë procedurë? Vendimi tjetër ka qenë ai nr. 811, datë 26.12.2018 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve dhe pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit për ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e vend-depozitimeve ekzistuese, Tiranë, dhe prodhimin e energjisë elektrike, Tiranë”.

Shpronësimi është bërë nga qeveria, nuk është bërë nga Bashkia Tiranë, në kuptimin që vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 284 milionë e 995 mijë e 840 lekë, sipas këtij vendimi, i është alokuar Bashkisë Tiranë të vazhdonte procedurën e shpronësimit. Natyrisht, përballimi i të gjitha shpenzimeve është bërë nga llogaria “fondi rezervë i buxhetit të shtetit”, miratuar për vitin 2018.

Të njëjtën përgjigje që ne e gjejmë në këtë dokument zyrtar, e gjejmë edhe në përgjigjen që na ka sjellë kryetari i Bashkisë Tiranë, se procedurën e shpronësimit e ka vendosur Këshilli i Ministrave dhe të hollat i ka dedikuar, po kështu, Këshilli i Ministrave, gjithmonë për arsyen që Tirana meritonte zgjidhje, kërkonte zgjidhje në vitin 2015, kur Sharra kishte 25 vjet që i shërbente grumbullimit të mbetjeve në Tiranë (që në 25 vjet, e imagjinoni sa është rritur Tirana, e më shumë sa njerëz jetojnë në Tiranë, më shumë se 1 milion shqiptarë jetojnë në Tiranë). Kjo duhet të na bëjë të gjithëve të përgjegjshëm për të kuptuar përmasën e problemit dhe ndërhyrjen për zgjidhjen e tij.

Dua të shpjegoj diçka lidhur me statusin juridik të tokës, ku sot ngrihet impianti i trajtimit të mbetjeve të Tiranës. Sipërfaqja totale është 120 hektarë, 60,1% është pronë shtet dhe 39,9% është pronë private, që shpronësohet sipas vendimit që unë sapo e solla në vëmendjen tuaj. Sipërfaqja që është marrë përsipër të shpronësohet nga shteti nuk është një sipërfaqe e vogël, sepse Sharra tashmë nuk është më në përmasat e dikurshme të para 25 vjetëve. Sipërfaqja është 478 mijë e 800 metra katrorë dhe për këtë sipërfaqe është dhënë ajo vlerë shpronësimi.

Më pas është miratuar procedura koncesionare dhe është miratuar, sepse Bashkia Tiranë, e cila ishte edhe kërkuesja, por edhe përgjegjësjë, në fakt, sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor” dhe atij “Për trajtimin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ka qenë dakord që në termat e propozuar problemi shtrohej të zgjidhej në atë mënyrë, për shkak se edhe Bashkia Tiranë ka qenë dakord, por ka qenë dakord edhe ministri i Financave, që, në rastin konkret, kur bëhet fjalë për çështje financiare, është ai që vendos për t’u dhënë rrugë akteve të ndryshme që propozohen në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

Tani, unë do të sjell në vëmendje edhe ligjin mbi bazën e të cilit funksionon Këshilli i Ministrave, që është, po ashtu, një ligj i vitit 2003 dhe ka pësuar ndryshime shumë-shumë të vogla, thjesht procedurale, sepse mbi të njëjtin ligj të vitit 2003, edhe sot në vitin 2022, kanë vepruar të gjitha qeveritë, të majta dhe të djathta, ku procedura e konsultimit ndërmjet ministrive është një procedurë rutinë pune, nuk është një procedurë e cila të amplifikohet sikur çfarë po ndodh.

Madje, më keq akoma, ajo që po ndodh është një krim i rëndë, është punë. Përfaqësuesit e kabineteve në institucionet e ndryshme qendrore përfshihen edhe në procesin e konsultimit të vendimmarrjeve që i duhet të bëjë Këshilli i Ministrave në bazë të këtij ligji. Por a penalizohet dikush për mendimet?

Në qoftë se ju dini që në Shqipërinë e vitit 2022 penalizohet dikush se ka këtë mendim, por më pas u vendos diçka tjetër apo se ndryshoi mendim rrugës, jeni të lutur që, bashkë me ato paditë që thoni se do të bëni, sepse nuk ju kanë ardhur përgjigje, por shpresoj të mos i bëni në emër të komisionit, se disa herë është falsifikuar në emër të komisionit, se duhet vendimmarrje në emër të komisionit para se të bësh diçka në emër të komisionit, bëjeni edhe këtë dhe çoni ministrat të çdo kohe aty, ku shihni apo ku gjeni, çojini edhe ata, dhe shikoni se çfarë përgjigjeje do të merrni. Mbajnë përgjegjësi penale për mendimet që kanë? Mbajnë përgjegjësi penale pse ndryshojnë mendimet? Se unë nuk e di. Ne pretendojmë se jemi në demokraci, por, në fakt,

konstatoj se ata që e mbajnë veten si kampionë të demokracisë, qenkan me mentalitet tërësisht komunist...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se nuk më bën sens.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e kuptoj dot që një orë e një çerek të sillet e të sillet përpara syve “Ky ka dhënë këtë mendim”.

Po shkoj edhe më tej akoma dhe po ju lexoj...

(Deputeti Bushati flet pa mikrofon.)

Të lutem, Helidon!

Po shkoj te neni i ligjit...

(Deputeti Bushati flet pa mikrofon.)

Po tani, kështu më duket. Më vjen keq që e thashë, por nuk kam me çfarë ta krahasoj, nuk gjeta një krahasim tjetër...

(Ilaritet në sallë)

...më të mirë ose më të përshtatshëm.

(Deputeti Bushati flet pa mikrofon.)

Helidon Bushati – ...kjo është rubrika “E pranojnë me gojën e tyre”.

Ermonela Felaj – Atëherë, si merren vendimet në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, se ndoshta kjo është interesante për dikë që nuk ka qenë ende në Këshillin e Ministrave?

Zoti Spaho besoj që e njeh nga fakti që ka përvojë të gjatë edhe ekzekutive, edhe parlamentare.

Anëtarët e Këshillit të Ministrave duhet t’i respektojnë vendimet e marra në mbledhjet e Këshillit të Ministrave. Ata duhet të mënjanojnë në mënyrë të veçantë çdo shprehje mospajtimi dhe të mbrojnë ose të përkrahin vendimet e lartpërmendura, pavarësisht nga fakti nëse kanë marrë pjesë ose jo në mbledhje, kanë votuar pro ose kanë votuar kundër. Pse kjo logjikë? Kjo sepse Këshilli i Ministrave është organ kolegjal dhe duhet të shfaqet unitar në vendimmarrjen e vet, pavarësisht debateve dhe vlerësimeve të ndryshme që ruajnë anëtarët e Këshillit të Ministrave në mbledhjet e përjavshme që organizon Këshilli i Ministrave çdo të mërkurë.

Vlerësimet, debatet dhe raportimet mbeten konfidenciale. Megjithatë, këtu që nga fillimi i ngritjes së komisionit, kemi dëgjuar një ankesë të vijuar: “Nuk kemi marrë informacione, nuk

dimë asgjë, por, në fakt, janë marrë edhe *e-mail*-e zyrtare dhe unë nuk kam asnjë problem se janë marrë *e-mail*-e zyrtare. Mund t’i keni siguruar në rrugë formale ose joformale, por, sidoqoftë, i keni siguruar nga persona zyrtarë dhe i keni bërë pjesë të mbledhjes së këtij komisionit hetimor për të treguar diçka që është rutinë e punës në Këshillin e Ministrave.

Vlera e investimit për landfillin e Tiranës është 128 milionë euro ose më mirë mos ta quaj “landfill”, sepse ne kemi një keqkuptim të madh për të. Nuk e kuptojmë çfarë është landfilli dhe nuk e kuptojmë që në landfill do të depozitohen mbetje, pamja e të cilave nuk ka si të jetë e krahasueshme me pamjet e bukura të revistave. Asnjëherë nuk janë të bukura, sepse janë pamje plehrash. Edhe një qese plehrash në shtëpi po ta fotografosh, nuk besoj se dikujt do t’i duket e bukur dhe do ta shpërndajë në ndonjë rrjet social, por ama duhet të ketë patjetër një vend që këto plehra të depozitohen dhe kjo është Sharra.

Çfarë do të ndodhë në Sharrë, se është akoma brenda zërave të kontratës? Do të ndodhë edhe insinerimi. Pra, përveç seleksionimit, kompostimit, riciklimit, të gjitha këto procese që ne i kemi thënë, ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem! Nuk po them asgjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë prandaj ju kam ftuar edhe ju dhe jam lodhur shumë për t’u mbushur mendjen që duhet të shkojmë, sepse të njëjtën gjë thatë edhe për Elbasanin, që nuk bëhet insinerimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, thatë edhe për Elbasanin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, të mos bëjmë debat. Nuk e di edhe me çfarë të drejte flet kur nuk ke qenë. Kur nuk ke qenë, të paktën na lërë atributin ne që kemi qenë të ta themi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të tregojmë edhe fotot ose t’i dërgojmë fotot në grup që t’i shikoni. Ka kabinë elektrike, ka matës të energjisë elektrike dhe ka të dhëna zyrtare që prodhohet dhe hidhet në rrjet.

Diskutimi me ERE-n kërkon të ngatërrojë publikun, sepse diskutimi me Entin Rregullator të Energjisë është për çmimin dhe është një diskutim i prejdardhur nga fakti që ka boshllëk ligjor, por që do të duhet ta zgjidhë një autoritet tjetër, nuk e zgjidhim dot ne këtu. Ama kjo nuk mohon faktin që nga insinerimi prodhohet energji. Imagjino, të djegësh dhe të mos prodhohet energji! Këtë pohim mund ta dëgjosh vetëm nga anëtarët e kësaj ane të komisionit hetimor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për Tiranën operacioni është shumë i thjeshtë. Vlerën e investimit mos e ngatërmoni me vlerën e shërbimit. Për çdo shërbim që bëhet për trajtimin e mbetjeve, pra, për çdo ton mbetje që dërgohet në Sharrë, do të paguhet 29 euro për ton. A bën bum ky çmim? Nuk na rezulton i tillë, sepse nga të dhënat e ndryshme statistikore, nga të dhënat që mund t'i gjykosh, qoftë edhe duke kërkuar në *google*, do të konstatojmë qartë që ky është një çmim i përafërt me çmimin mesatar që përdoret gjithandej nëpër Europë ku funksionojnë impiante të ngjashme.

Për të shkuar më tej dhe për të sjell një krahasim, në kohën kur kryetar bashkie ishte zoti Basha dhe nënkryetare ishte zonja Tabaku, dhe mund të na e konfirmojë, ka pasur një studim të Bankës Botërore, që ofronte çmimin 37 euro për ton. Tani është 29 euro për ton.

Po të vijmë te sasi të ndryshme dhe tarifatat që përdoren për ton, unë kam këtu një listë të gjatë të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, duke filluar me Austrinë, Belgjikën, Bullgarinë, Çekinë, Danimarkën, Estoninë, Finlandën, të cilën mund t'ju vë në dispozicion për të parë tarifatat për ton të mbetjeve, të cilat na tregojnë qartësisht që tarifa 29 euro për ton, që paguhet për shërbimin që është duke ofruar koncesionari në landfillin e Sharrës, është një tarifë e përafërt dhe nuk është një tarifë e padëgjuar, e cila të na çojë në argumentin që qeveria dhe gjithë të tjerët vepruan si një grup i strukturuar kriminal.

U sollën disa herë në vëmendje argumentet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kontrolli i Lartë i Shtetit është një institucion i rëndësishëm, për të cilin flet Kushtetuta, por aktet e këtij organi janë administrative dhe si të tilla janë të kontestueshme në rrugë administrative apo në rrugë gjyqësore. Kjo do të thotë që jo çdo pohim që bën KLSH-ja është i natyrës që ty të penalizon përfundimisht, sepse të tilla janë vetëm ato çfarë gjykata vendos përmes vendimeve të formës së prerë. Ato janë të detyrueshme për t'u respektuar, për t'u zbatuar, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbajtur parasysh, na pëlqen apo nuk na pëlqen.

Për pjesën tjetër, e dimë të gjithë (besoj secili edhe nga përvoja e punës së mëparshme) që Kontrolli i Lartë i Shtetit bën raportet e veta, sigurisht, në zbatim të ligjit ka edhe ai detyrimet

e veta, por unë nuk di që për mospërmbushje kontraktore, fjala vjen, Kontrolli i Lartë i Shtetit të ketë kallëzuar dikë në rastin konkret, sepse nëse nuk e ka kallëzuar, atëherë i bie që ka vepruar në kundërshtim me ligjin. Nëse ka menduar që mospërmbushja kontraktore në vetvete është vepër penale, është mashtrim, falsifikim apo diçka tjetër dhe nuk e ka kallëzuar, atëherë presupozohet që edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit të ketë kryer një vepër penale, kushdoqoftë ai që e ka bërë raportin.

Nga ana tjetër, dua të sjell në vëmendje që kontratat janë civile, lidhen në bazë të ligjit civil, palët kanë liri kontraktore dhe jo çdo mospërmbushje kontraktore e detyrimeve që ka kontrata është objekt i punës së prokurorisë ose është objekt i parashikimit të ligjit penal. Nuk di si ta them ndryshe, sepse sa herë e dëgjoj këtë gjë realisht nuk i gjej sens.

Argumenti i fundit. Këtu u soll në vëmendje edhe Durrësi. Përpara se të merrem me përmbajtjen e dokumenteve kryesore të administruara nga institucionet shtetërore, më tërhoqi vëmendjen një shkrim i botuar te “Panorama”, i shkruar nga një profesor docent, Seit Shahinllari, përgjegjës i Departamentit të Agro-Mjedisit dhe Ekologjisë në Universitetin Bujqësor të Tiranës: “Ndotja në Porto Romano nga mbetjet, rrjedhjet toksike drejt nëntokës dhe detit, si dhe gazrat me përmbajtje të substancave toksike, kancerogjene, që përfundojnë në mushkëritë e studentëve dhe banorëve aty afër duket se po ia lënë vendin rehabilitimit pas dekadash në qytetin ku kalon fluksi më i madh i turistëve gjatë stinës së verës”.

E dini sa turistë pushojnë në Durrës gjatë stinës së verës? Këtë mund ta them nga fakti që bashkë me kolegen Dhima kemi qenë anëtare të Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Kolegia Dhima vazhdon të jetë anëtare e këtij komisioni. Në takimet që kemi pasur me Drejtoritë e Policisë së Shtetit në çdo qark kemi marrë një të dhënë që Durrësi dhe Vlora përballojnë një fluks turistësh që shkon mbi 1,5 milionë turistë në vit. Është një shifër shumë e lartë, prandaj mendoni çfarë mbetjesh grumbullohen nga fakti që aty pushojnë kaq shumë njerëz.

Mbase asnjëherë nuk do të merret vesh sa vite jetë u shkurtuan ose sa persona u prekën nga sëmundjet e rënda. Për profesorin, që nuk është as Ermonela, as Jorida dhe asnjë nga anëtarët e këtij komisioni, është lajm shumë i mirë që u mbyll Porto Romano dhe është lajm shumë i mirë që Sharra mund t’i shërbejë edhe trajtimit të mbetjeve që ka Durrësi. Sharra është vetëm 40 kilometra larg nga Porto Romano dhe e gjitha mund t’i shërbejë fare mirë edhe Bashkisë së Durrësit.

Megjithatë, në këtë komision është thirrur për të dëshmuar kryetarja e komanduar e bashkisë së Durrësit, zonja Sako, dhe besoj se do të keni durim deri atëherë për të dëgjuar edhe argumentimin, edhe për të kuptuar se me çfarë problematike është përballur bashkia e Durrësit dhe si u detyrua ta zgjidhë atë.

Me këtë rast kujtoni që edhe në vend-depozitimin e Radës ka pasur protesta nga ana e banorëve, sepse askush nuk i do plehrat afër. Mirëpo, parimi që ndjek e gjithë bota është, kush ndot, paguan dhe ky është një shërbim që paguhet, nuk është një shërbim që mbin dhe bie nga qielli aty dhe ne t'i gëzohemi, nuk është një shërbim që funksionon vet pa pasur dikë që e menaxhon dhe e administron e të tjera me radhë.

Unë e kuptoj që ju do të donit që nga viti 2013 deri në vitin 2022 të mos ishte bërë asgjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mos ishte bërë asgjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo del logjikisht. Meqë këto qenkan bërë të gjitha keq, meqë të gjithë u përfshinë në krim, meqë të gjithë bashkëpunuan me njëri-tjetrin në kohë reale, brenda ditës, natën, ditën, pushimet e verës, ditë të shtuna, ditë të diela, se kjo histori i është dhënë publikut, atëherë do të ishte mirë ta mbanim Sharrën siç ishte, të shikonim pamjet e fëmijëve romë, egjiptianë apo edhe të tjerëve, të cilët shkonin atje për të mbledhur kanaçe, dhe me këtë rast t'i kujtonim zonjës Tabaku kush u përfshi në riciklimin e mbetjeve të Tiranës, se me siguri e ka njohur kunatin e kryetarit të partisë së saj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kam nevojë, të kam ty që e dëshmon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ato që po dëshmon duke reaguuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër. Do të vij kryetari i bashkisë së Tiranës në këtë komision dhe do t'i thotë të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shpresoj që deri atëherë t'i riktheheni edhe një herë procesit të të menduarit jeni apo nuk jeni ju në konflikt interesi me këtë çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, në ndryshim nga anëtarët e tjerë të komisionit, ju keni pasur përgjegjësi si nënkryetare, keni zëvendësuar kryetarin dhe sipas ligjit keni pasur përgjegjësi për trajtimin e plehrave. Po çfarë bëtë? E latë ashtu deri në vitin 2013.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka nevojë të gjej shkresa. Është kujdesur media me emisione të tëra në News 24. Nuk besoj se ka qytetarë që nuk e kujtojnë sa shumë është marrë News 24 veçanërisht me Sharrën, me atë malin shkumbues atje që nuk i hynte në sy askujt nga këta që sot përpiqen të gjejnë qimen në syrin e tjetrit, por që kanë pasur gjatë gjithë kohës trarin në sytë e tyre. Për këta Elbasani duhet të vazhdonte të ishte njëlloj, të mos rehabilitohej asgjë, madje edhe sot nuk shikojnë asgjë. Të paktën atë që e shikon, thuaje, kjo ishte në Elbasan. Në Elbasan pamë grumbuj mbetjesh të seleksionuara që u përkisnin mbetjeve të xhamit dhe të shisheve. Mund ta thotë dikush që nuk e pashë? Pamë plehra të depozituara në një vend, pamë landfill ku depozitohen rrjedhjet e ujërave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ngjitur me lumin Shkumbin, Lefter, sepse, siç edhe na u tha atje, dhe siç e pohoi edhe kolegu yt nga Elbasani, ajo ka qenë sipërfaqe ku depozitoheshin të gjitha mbetjet e industrisë së metalurgjikut të Elbasanit. Bashkia zgjodhi atë sipërfaqe për ta rehabilituar, sigurisht për të ulur kostot, brenda vlerës së atij investimi dhe për të siguruar që nuk do të ketë më asnjëlloj cenimi të lumit Shkumbin, sepse janë vendosur shtresa që nuk lejojnë rrjedhjen e ujërave dhe janë hapur puse. Kolegët ishin atje, por në qoftë se kanë dyshime të tjera, të marrin ekspertë dhe të na e thonë ekspertët përgjigjen, por ne nuk mund të japim përgjigje që nuk na takojnë. Ne mund të flasim vetëm për atë që pamë qartësisht të gjithë së bashku.

Për ju Fieri duhet të ishte njëlloj. Ju ftoj të shkoni te ish-fusha e mbetjeve në Fier dhe do ta konstatooni vetë që është realisht disa metra më e lartë sesa terreni ku duhet të ishte. Pse? Sepse për 45 vjet u mblodhën të gjitha mbetjet e Fierit. Është në hyrje të Fierit. I ka njerëzit ngjitur. Problemi që ju e ngrini ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ina, mos u shqetëso. Unë të dëgjova, pavarësisht se nuk më pëlqyen të gjitha ato që thatë ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk të ndiqja dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti mund të mos dëgjosh nëse nuk të pëlqen, por ky nuk është problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fola për Tiranën. Besoj se kaq e kuptove.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fola për Tiranën dhe jam duke thënë (që ta kuptoj publiku në fakt), që për ju do të ishte më mirë që ne të kishim ngelur po njëlloj, ashtu siç e pohon edhe shkresa që na ka sjellë INSTAT-i, i cili thotë që deri në vitin 2013 nuk kishte të dhëna statistikore të sakta për mbetjet që krijoheshin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, por kishte vetëm të dhëna që u referoheshin rekordeve administrative të marra aty-këtu. Pas vitit 2014 ka filluar mbledhja e të dhënave dhe falë asistencës së Bashkimit Europian sot mbledhja e të dhënave bëhet sipas metodologjive që zbatojnë edhe vende të tjera europiane. Ka një sistem të posaçëm për mbledhjen e këtyre të dhënave, të cilat mblidhen nga çdo autoritet, dhe mbledhjen e të dhënave e bën INSTAT-i, jo qeveria. Një e detaj që mua më tregon që askush nuk mund të dyshojë se qeveria ndërhyr në të dhënat që dalin prej këtij institucioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem! Nuk mund të më ndërpresësh fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ma ndërpret duke pretenduar që unë të them atë kërkon ti. Nuk të ndërhyra, zonjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonjë, bëre çdolloj komenti dhe nuk ju ndërpreu njeri, as për mënyrën si e menaxhuat rendin e ditës.

Në vitet 2013-2020 janë gjeneruar 1 606 639 ton mbetje. Nëse kjo nuk është një shifër që flet, nëse kjo nuk është një shifër që tregon se dikush duhet të lëvizte nga vendi dhe dikush duhej t'i përgjigjej me metoda moderne trajtimit të mbetjeve, këtë unë e pres vetëm nga akuzatorët, gjyqtarët dhe policët e kësaj ane, që i keni vënë aty për të na bërë gradën e shtatë. Pjesën tjetër e gjykon më mirë publiku dhe unë i besoj jashtëzakonisht jo vetëm gjykimit të publikut, por i besoj sjelljes së atyre njerëzve, të cilët kanë qenë më të dëmtuar nga historia e rëndë e mbetjeve të krijuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, që sot, për fat të mirë, falë impianteve, e kanë lënë pas atë histori. Te historia e maleve shkruambuese nuk kthehem më, kurse tek ajo që kemi sot patjetër që kërkohet përgjegjësi dhe është përgjegjësi e shtuar. Nuk është thjesht përgjegjësi

administrimi dhe menaxhimi, por është përgjegjësi ndaj njerëzve, sepse çdo cedim aty është pasojë e drejtpërdrejtë në jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Mua si parlamentare dhe besoj të gjithë anëtarëve të këtij krahu na ka interesuar pikërisht kjo gjë që duhet të shikonim atje, sepse e nisëm nga momenti kur nuk kishte asgjë, nuk bëhej asgjë, por, në fakt, terreni na ka treguar një të vërtetë tjetër, që është mirë ta prekësh duke e parë dhe jo ta komentosh sipas vlerësimit personal, interesit personal apo interesit partiak.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Ka kërkuar fjalën zonja Dhima dhe më pas zoti Spaho.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Kujtesa është aftësia e një organizmi të mbajë, të ruajë, të rendisë informacionet dhe t'i rikujtojë ato, kurse harresa është e kundërta e kujtesës.

Dua t'u kujtoj kolegëve të opozitës se në vitin 2013, bazuar në të dhënat e INSTAT-it, 50% e mbetjeve të qytetarëve hidheshin në kosh, nga të cilat vetëm 16% e tyre depozitoheshin në vendgrumbullim me kushte sanitare, kurse 50% të tjera hidheshin për qejf të vet në natyrë. Në vitin 2013 ka pasur vetëm dy pika fundore, ajo e Bushatit dhe e Sharrës, ku mbetjet nuk trajtoheshin, por thjesht grumbulloheshin.

Pas 8 vjetëve, po përsëri sipas INSTAT-it, 82% e mbetjeve grumbullohen dhe nga këto 69% depozitohen në landfille. Sot kemi gjashtë impiante të trajtimit të mbetjeve, të cilat ofrojnë shërbim për 68% të popullsisë, përkundrajt 15,9% që ishte në vitin 2013.

Në këtë mandat të tretë qeverisës ne kemi prioritet jo vetëm menaxhimin e mbetjeve, por, njëkohësisht, edhe ndërgjegjësimin e shoqërisë, pasi jemi ne ata, të cilët prodhojmë mbetje urbane.

Duke respektuar edhe autonominë vendore, zonja Tabaku, ne nuk mund të mos merremi dhe nuk mund të mos shqetësohemi për problemet e pastrimit në territor, pasi nuk mund të ketë respektim të autonomisë vendore pa respektuar mjedisin, pa respektuar sigurinë dhe shëndetin e banorëve, por edhe të turistëve që frekuentojnë vendin tonë, të cilët po rriten në numër nga viti në vit.

Nga ana e qeverisë shqiptare janë marrë dy vendime shumë të rëndësishme në drejtim të administrimit të mbetjeve urbane. E para është përlllogaritja e kostove dhe tarifave të shërbimit dhe e dyta është metodologjia për ngritjen e një baze të dhënash të unifikuara me informacionet që vijnë nga ana e bashkive në lidhje me mbetjet e gjeneruara në territoret e tyre.

Ndryshe nga ju, që nuk e keni pasur në kalendat tuaja prioritet pastrimin, ne e kemi detyrë patriotikë dhe njëkohësisht kauzë kombëtare. Këtë ne e kemi treguar dhe po e tregojmë në të gjithë territorin e vendit, pasi një ambient i pastër është një mundësi për zhvillim ekonomik dhe social.

Institucionet janë aty, njëkohësisht edhe insineratorët, edhe impiantet e trajtimit të mbetjeve. Ne kemi vizituar Fierin, Elbasanin dhe sot do të vizitojmë Tiranën. Sipas njoftimeve që ne u kemi bërë, dëshmitarët do të vijnë të dëshmojnë pranë këtij komisioni për përgjegjësinë, për angazhimin, si dhe për procesin që ata kanë kryer gjatë ndërtimit, administrimit dhe njëkohësisht gjatë menaxhimit të impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta. Nuk ka përgjegjësi kolektive, gjithsecili nga ne ka përgjegjësi individuale.

Ne kemi treguar gjatë gjithë kohës që jemi në qeverisje që përgjegjësia është individuale, jo kolektive dhe këtë gjë po e tregojmë edhe në këtë komision. Kini durim dhe respekt për njerëzit që janë marrë me këto procese dhe për institucionet, sepse ne jemi këtu për më të mirën e atyre qytetarëve që na kanë votuar dhe besuar.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – Të gjithë ata që kanë dëshirë të flasin, do të flasin, por unë kërkoj të fokusohemi te insineratori i Tiranës. Detyrat patriotike janë shumë të mëdha dhe nuk i mbajmë dot mbi shpatulla ne në këtë komision.

Po, zonja Denaj.

Anila Denaj – Faleminderit!

E vlerësoj faktin që ne dëgjuam këtu se si nuk mungoi transparenca me raportet e Ministrisë së Financave që ju përmendët. Sigurisht, kur vjen puna për transparencë nga institucionet financiare, kalohet shpejt. Megjithatë, e përmendët si referencë të monitorimit të pagesave që do të thotë se fakti, që e gjetët ju, e gjen kushdo dhe Ministria e Financave, si dhe cilido institucion, që ka detyrimin ligjor të realizojë një monitorim, e realizon atë dhe nuk ka aspak diçka, të cilën duhet ta hedhim poshtë. Shumë mirë që e përmendët, sepse, në bazë të tyre, vlerësohen pagesat edhe të Thesarit.

E tha pak më parë zonja Felaj, dhe duhet të ritheksoj se në asnjë nga rastet nuk është bërë një analizë shumë e qartë e shifrave midis pagesave, që lidhen me investimin dhe ato që lidhen me shpenzimin e grumbullimit të plehrave në vendgrumbullim. Do të ishte shumë e nevojshme

që dhe kjo të bëhej. Ne mund ta thellojmë edhe gjatë javës tjetër, absolutisht, por, duke vendosur shifra, të cilat kanë prejardhje të ndryshme, njëri është investim, tjetri është shpenzim, mund të konfondohet dhe raportet janë aty për t'iu referuar.

Përmendet, gjithashtu, dhe dua të mbetem në mënyrë strikte te pjesa e Ministrisë së Financave, pasi, duke pasur edhe eksperiencën e viteve të fundit, mendoj që komisionin e ndihmon edhe qartësia e disa komenteve që u hodhën sot. Tavanet buxhetore edhe në shkresën e komunikimit midis ministrive shpesh ministrinë e financave i kanë këto të lakuara në komentet e tyre, sepse ka gjithmonë ministri, të cilat, sipas fushës së veprimtarisë së tyre, në strategjitë e tyre marrin iniciativa që kanë kosto. Nuk ka asnjë veprim që do të vijë pa një kosto, mund të jetë e lartë, e ulët, e mesme, është gjithë tjetër ta gjykosh, por kostoja është pjesë e padiskutueshme e çdo veprimi brenda një strategjie kombëtare dhe për këtë arsye ka një qarkullim komunikimi, ku bën pjesë Ministria e Financave. Po të vendosësh këtu si një problem pse Ministria e Financave vendos në përgjigjen e saj, që nuk është parashikuar në tavanet buxhetore, sepse është një kosto e pushtetit vendor, është e gabuar, sepse konfondon.

Pushteti vendor ka kohë që ka një autonomi financiare dhe marrja përsipër e kostove për një strategji, të cilën e menaxhon dhe drejton vetë, duhet të jetë shumë e qartë për publikun se ku fillon e mbaron përgjegjësia.

Së fundi, në raport me vendimin e Këshillit të Ministrave që zonja Zhupa përmendi si një proces, VKM-ja e shpenzimeve, e cila është bërë shumë kohë më mbrapa, VKM-të e shpronësimeve marrin kohën e tyre, nuk mund të ndodhë që të gjitha të ndodhin në të njëjtën ditë, pra edhe një plan diskutimi strategjinë, edhe një plan financimi, edhe një mendim i Këshillit të Ministrave për shpronësimin. Është shumë e rëndësishme të themi se ky vendim është marrë, është marrë në kohë dhe është realizuar. Ne kemi diskutuar këtu pse në çështjen e Fierit u ndryshua vendndodhja dhe u kemi bërë referencë edhe arsyeve teknike të vendndodhjes dhe përsëri vijmë e flasim për elementë që lidhen me kohën. Nëse ka vendimmarrje, të cilat kanë nevojë për kohë, për të marrë lejet, për të bërë shpronësimet, për të realizuar objektivin infrastrukturor për një plan, i cili shkon jo vetëm për sot, por dhe për vitet që do të vijnë, është shumë e rëndësishme që kjo kohë të merret e të analizohet. A do të ishte e mundur të analizohej që ditën e parë? Kjo mund të analizohet në këndvështrimin tim, sigurisht që edhe mundet, por a i kemi të gjitha informacionet? Jo! Sepse shumë nga vendimet dalin rrugës pasi shumë elemente teknike ofrohen rrugës. E rëndësishme është që vendimet të merren nga institucionet shtetërore

përkatëse dhe të merren me dokumentacionin përkatëse. Nëse këto marrin kohë, atëherë edhe kjo kohë duhet të analizohet dhe jo vetëm të gjykohej.

Këto ishin disa nga komentet për ato që u thanë sot, që duhet të sqarohen për të mos lënë vetëm kakofoninë dhe informacionin e përgjithshëm, pasi kemi detyrim për t'i sqaruar qytetarët për të gjitha detajet, edhe për ato teknike.

Edmond Spaho – Në fakt, jo më kot thashë se duhet të tregohemi seriozë kur flasim këtu. Jemi të gjithë me eksperiencë shumë të gjatë qeverisëse dhe nuk është e udhës që ju të përpiqeni të na portretizoni si idiotë. Ne nuk po themi se nuk duhet të hiqen plehrat, plehrat do të hiqen. Përpunimi i mbeturinave është sfidë e të gjitha shoqërive në Europë. Ne nuk po themi se nga djegia e plehrave nuk prodhohet energji elektrike. Nuk po i hyjmë debatit nëse duhet të bëhet me djegie apo me forma të tjera; nuk po i hyjmë debatit nëse kjo me djegie përputhet me direktivën e KE-së apo jo, ne po diskutojmë procedurat e ndjekura për këto 3 projekte, si dhe aspektet financiare. Për shembull, ju mund të thoni se prodhohet energji elektrike në Elbasan, por mua më intereson procedura që është ndjekur nga shteti, nga ministria dhe nga pushteti vendor për lidhjen e kontratës. A ka pasur emergjencë mjedisore në Elbasan? Nëse ka pasur, kush e ka shpallur? Të shikojmë dokumentin. Pse duhet kjo? Duhet, sepse është kontratë me negociim, ndryshe, sipas autoritetit të prokurimit, do të duhet të ishte tender i hapur dhe për këtë janë në burg ata, sepse kanë shkelur ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, do t'i hyjmë kësaj, sepse për këtë e kemi ngritur komisionin. Këtu janë abuzimet. Këtë duhet të bëjmë ne, sepse është bërë kontratë me negociim. Duhet të respektohet ligjin. Këtë do të shikojmë ne edhe kur të pyesim dëshmitarët. Pse ka dy kontrata një për djegësin, një për centralin elektrik, një 7 vjet, një 25 vjet? Janë paratë e shtetit, e kanë ndërtuar me paratë e mia dhe të tuat. Përse nga energjia elektrike ne marrim vetëm 2%, kur edhe centrali elektrik është ndërtuar me paratë e mia? Pse ai duhet të marrë 98% dhe unë duhet të marrë 2%? Ja, këto gjëra duhet të diskutojmë ne, kostot e mbledhjes së plehrave.

Është shumë e drejtë ajo që thoni ju se, po u pastruan plehrat, do të paguash. Po, do të paguajmë. Nuk ka më me punë vullnetare, as qesim, nuk të lë njeri. Po kur duhet ta paguaj 2 lekë, pse të paguaj 100 lekë? Këtë diskutim po bëjmë këtu.

Hajdeni të tregohemi seriozë dhe mos na vini alternativa të tilla: “Ju nuk jeni për të pastruar plehrat. Ju nuk e dini që prodhohet energjia elektrike edhe nga djegia e plehrave”. Nuk po i thotë njeri këtë gjëra.

Jorida Tabaku – Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Në fakt, doja të ndalesha në 3 pika.

E para, duhet të jemi të gjithë të qartë që çështja e menaxhimit të mbetjeve ka 2 aspekte: aspektin e mbledhjes dhe të largimit nga qyteti, e cila bëhej, por, kur arriti një pikë kur kjo gjë nuk mjaftonte, duhej që të përpunoheshin mbetjet. Këtu fillojmë e flasim për një mentalitet tjetër, jo thjesht t’i mbledhin dhe t’i largojnë nga qyteti, por edhe atje, ku i depozitojmë, t’i përpunojmë. Këto 2 aspekte sigurisht që do t’i shtojnë kostot. Nëse ne do të vazhdonim që vetëm t’i largonim nga qyteti, do ta vazhdonim atë kosto që kemi pasur ndër vite, por fillojmë të mendojmë me një filozofi tjetër, sepse lind i domosdoshëm përpunimi i këtyre mbetjeve. Këtu hyjnë këto procedura për të cilat po flasim, sepse dëgjova që u tha se na u shtuan kostot me këtë. Sigurisht, do të shtoheshin, sepse po prodhohen aq shumë mbetje, sa nuk kemi më ku t’i mbajmë dhe do të duhet detyrimisht që t’i përpunojmë. Kjo ishte e para dhe doja të ishte e qartë edhe për ata që na dëgjojnë e shikojnë.

E dyta, ju e përmendët në fjalën tuaj pjesën e inflacionit dhe lidhjen e kontratës në euro. Si një person që në jetën e tij private ka lidhur shumë kontrata kombëtare dhe ndërkombëtare, ky është një lloj risku që merret dhe njeriu përpiqet të parashikojë nëse është më mirë ta lidhë kontratën me monedhën lokale apo në atë të huaj. Na rezulton se kjo lloj kontrate e lidhur në monedhë të huaj i ka sjellë favore buxhetit për sa u përket shpenzimeve, për efekt të ndryshimit të kursit të këmbimit. Nga një llogaritje e shpejtë që bëra tani, duke marrë sasinë minimale që u përmend prej 700 tonësh, deri sot flasim për disa milionë euro të kursyera në diferencë të kësaj gjëje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, mund t’jua jap edhe me shifra. Ndryshimi i kursit midis vitit 2016 dhe vitit 2017 ka sjellë rreth 150 mijë euro diferencë vetëm për 700 tonë. Në vitet 2017-2018 ka sjellë rreth 560 mijë euro diferencë në çmime. Po ta kishim lidhur në lekë, do të paguanim më tepër, e lidhur në euro është paguar më pak. Mund të shkonte e kundërta, por realiteti është ky. Ky është risku kur ti lidh një kontratë në një monedhë ose në një tjetër.

Ajo që doja realisht të thosha, dhe e mora fjalën, është që, për fatin tim të mirë dhe të familjes sime, nuk kam banuar ndonjëherë në Kombinat apo në rrethina (për fat të keq të atyre që banojnë atje do të doja ta thosha këtë gjë), por për disa vjet kam përfaqësuar në Kuvendin e Shqipërisë zona në kufi me Sharrën, si Peza dhe Ndroqi, e më ka qëlluar të kaloj shumë shesh në zonën e Kombinatit në orare të ndryshme, ishin momente kur aty nuk jetohej më nga era e keqe dhe nga tymrat që lëshoheshin në ajër. Të paktën këtë realitet sot duhet ta pranojmë. Ne mund të flasim për shumë kosto. Ne flasim dhe bëjmë mirë të flasim edhe për kosto, edhe për procedura, por të mos harrojmë që aty jetojnë qytetarë, jetojnë njerëz që kanë fëmijë, jetojnë ditë për ditë dhe ajri, me të cilin përballen sot, është krejtësisht një realitet tjetër. Sot nuk është më hall të banosh në Kombinat dhe në zonat përreth Sharrës. Besoj se qytetarët e kuptojnë mjaft mirë këtë dhe e treguan me votën e tyre në vitin 2021.

Jorida Tabaku – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

E ka kërkuar fjalën zoti Këlliçi, më pas zoti Nasufi.

Belind Këlliçi – Faleminderit!

Këtu ka një problem, se këtu po maxhoranca hiqet sikur opozita në këtë komision kërkon që situata me trajtimin e plehrave të mos ndryshojë, ne jemi kundër pastrimit të qyteteve, ne jemi kundër prodhimit të energjisë nga inceneratorët e të tjera, kur ndërkohë qëndrimi ynë që ditën e parë në këtë komision dhe qëndrimi i opozitës që ditën e parë, që është folur për aferën e inceneratorëve, ka qenë se ne jemi kundër korrupsionit dhe vjedhjes së parave të taksapaguesve shqiptarë.

Tani dëgjova zonjën Felaj, e cila tha se çmimi 29 euro rezulton një çmim shumë i mirë, edhe pse raporti i KLSH-së e nxjerr 41 euro çmimin për ton, megjithatë po e trajtojmë 29 euro. Qytetarët e Tiranës duhet të kuptojnë se çfarë kanë sjellë inceneratorët për qytetin e Tiranës dhe për xhepat e taksapaguesve sot është dyfishuar tarifa për pastrimin e qytetit të Tiranës edhe për shkak të inceneratorëve. Në total sot qytetarët e Bashkisë së Tiranës paguajnë 24 milionë euro në vit për pastrimin e qytetit dhe të gjithë i kemi parasysht punonjësit që më tepër bëjnë pluhur kur fshijnë natën sesa pastrojnë edhe ditën, edhe makineritë që lënë qytetarët në rrugët kryesore të Tiranës pa gjumë në orë të papërshtatshme çdo mbrëmje. Të gjithë e kemi parasysht që pjesa 12 milionë euro, që paguhet për inceneratorët, është parapagesë për një shërbim që nuk ofrohet, sepse sot në inceneratorin e Tiranës nuk digjen plehrat. Problemi këtu është që e përkthyer në shifra, do të thotë që çdo muaj qytetarët e Tiranës të paguajnë 2 milionë euro për pastrimin e

qytetit dhe çdo ditë të paguajnë 71 mijë euro apo 85 milionë lekë të vjetër për të pastruar Tiranën. Këtë duhet t'ua shpjegojmë opinionit publik dhe qytetarëve se çfarë përfitimesh kanë këta qytetarë me këtë shifër marramendëse 500 mijë euro në javë që paguhet për të pastruar kryeqytetin, paguhet 500 mijë euro në javë për një shërbim që nuk ofrohet.

Shumë mirë që do të shkojmë në inceneratorin e Tiranës. Unë kam qenë vetë bashkë me zonzjën Tabaku dhe zonzjën Zhupa, megjithatë uroj që të mos shkojmë për të parë akaciet apo eukaliptet, por të shikojmë malin me plehra që është po aty, që e shikojnë të gjithë në rastin kur kemi ceremoni mortore në varrezat e Sharrës dhe të gjithë e shikojmë se si është gjendja katastrofale atje. Të gjithë e dimë se sot në inceneratorin e Tiranës nuk ka incenerator, por landfill. Meqenëse thoni se sot po përdoren metodat më moderne të pastrimit të qytetit përmes incenerimit dhe djegies së plehrave në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve objektiva kryesorë keni: parandalimin, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve me kushtin primar të ndarjes së tyre në burim. Këtë e thoni ju. Propozime kryesore keni: parandalimin, përgatitjen për ripërdorim, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin. Tani, ku hyn incenerimi këtu, meqenëse po përdorini metodat më moderne, që nuk i keni përfshirë fare në strategjinë tuaj kombëtare?

Ndërkohë, ju e dini shumë mirë që incenerimi ka kosto shumë të larta, dekurajon riciklimin dhe çliron substanca të rrezikshme nëse nuk janë të instaluar filtrat e duhura. Për këtë arsye po marr Gjermaninë, ku incenerimi është metoda më e fundit e përdorur për trajtimin e mbetjeve në këtë shtet që është lider në rajon dhe në Europë.

Ndërkohë, zonzjë, gjatë fjalës suaj përmendët që ligji tashmë nuk ka më ofertat e pakërkuara, nuk i trajton. Ne nuk po flasim për ligjin aktual, por po flasim për momentin kur janë lidhur kontratat që kanë qenë oferta të pakërkuara, këto që janë depozituar dhe kanë fituar. Po flasim për një rast, duhet ta kuptojnë qytetarët, në rastin konkret më 30 gusht të vitit 2017 një kompani me kapital 800 euro, e themeluar në datën 30 gusht, pas 24 orësh fiton një kontratë me shtetin shqiptar në vlerën 100 e 28 milionë euro. Tani unë i mbaj mend shumë mirë deklaratat publike të kryetarit të Bashkisë së Erion Veliajt, kur doli në medie, pak ditë pas ndarjes nga jeta të të ndjerit Ardit Gjoklaj dhe paralajmëroi ardhjen e një kompanie të famshme holandeze me shumë eksperiencë në Tiranë që do të bënte trajtimin e plehrave dhe do të investonte në landfillin e Sharrës. Vetëm ju jeni ata që sot Klodian Zoton e trajtoni si holandez, sepse nuk ka shqiptar që nuk e di se kjo kompani është e njëjta kompani pas së cilës është inceneratori i Fierit, i Elbasanit; është Klodian Zoto që nuk ka as shtetësi holandeze në dijeninë

time. Formalisht mund të ishte me shtetësi holandeze, por nuk është. Zoti Klodian Zoti është i ftuar të vijë në këtë komision, por nuk e di a do t'i gjeni dot adresë, sepse është në kërkim ndërkombëtar. Pak ditë më parë në shtëpinë e tij janë sekuestruar pajisje elektronike kompjuterë, laptop. Uroj që SPAK-u të bëjë detyrën dhe t'i zbardhë të gjitha informacionet që ndodhen në këto pajisje të sekuestruara.

Realisht, do shumë guxim që sot të dalësh publikisht dhe të mbrosh këtë aferë. Është një aferë tërësisht korruptive, kryekëput e jashtëligjshme në shkelje të ligjit. Sot minimalisht ish-ministrin e Mjedisit e keni në burg. Ka një arsye logjike, qytetarët e Tiranës duhet të kuptojnë pse është firmosur kontrata më 31 gusht, sepse edhe një javë ishte Lefter Koka ministër i Mjedisit dhe ikte, kishte marrë përsipër për ta çuar deri në fund. Pas një jave u zëvendësua. E firmosi, bëri detyrat e shtëpisë dhe e çuat aty ku e çuat. Jam i bindur se nëse i shkohet deri në fund kësaj afere, do të dalim te pronari i vërtetë i inceneratorit, që është Edi Rama. E dimë ne se kush është personi që ka fuqinë në këtë vend që të kalojë 14 vendime brenda një ditë të institucioneve shqiptare, të thyejë rekord botëror ndoshta, të na fusë në Gines për eficiencë qeveritare dhe që ta çojë këtë aferë deri në fund, t'i detyrojë të gjithë ministrat, të gjitha institucionet të jenë në rresht për një.

Patjetër që do të vijë të flasë këtu Erjon Veliaj, të dëshmojë se si i mori kompetencat si kryetar i qarkut të Tiranës. Ka firmosur zotëria dhe ka dhënë urdhër për trajtimin e mbetjeve jo vetëm për Bashkinë e Tiranës, por ka marrë atributet e këshillit bashkiak edhe të Rrogzhinës, Kamzës, Vorës dhe ka Kavajës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të hanë kokat me njëri-tjetrin. Nuk ka lidhje. Ajo që është e rëndësishme, po e them edhe një herë se kurrkush nga ana e opozitës... Por ju ftoj që, nëse dispononi dokumente ose informacione në lidhje me ndonjë deklaratë të ndonjë deputeti të opozitës që është shprehur se është kundër pastrimit të qytetit apo kundër trajtimit të mbetjeve qoftë të Tiranës, Fierit, të Elbasanit, ta bëni publike. Por mjaft gënjyet opinionin publik! Askush nuk është kundër trajtimit të mbetjeve dhe pastrimit të qyteteve. Jemi kundër vjedhjes dhe korrupsionit. Kaq e thjeshtë është.

Jorida Tabaku – Ka kërkuar fjalën zoti Nasufi, më pas zoti Bushati. Zoti Bushati ka 4 mbledhje komisioni që nuk flet. Ne kemi folur pak më shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Helidon Bushati – Kur të fillojmë pyetjet, do të të vjedh profesionin.

Fadil Nasufi – Në vazhdim të gjithë këtij debati që po zhvillojmë, e para që interpretojmë të gjithë planin e hetimit, dhe sot në rastin e Tiranës, ne duhet të jemi të njëzëshëm në atë që tha edhe zoti Pëllumbi në mënyrën dhe qasjen që kemi ndaj një trashëgimie shumë problematike me mbetjet urbane, ku territori ka qenë shumë kërcënues për jetët tona dhe ku kultura e trajtimit të mbetjeve ka qenë kaotike, çedukuese dhe shkatërruese për gjithçka tjetër.

Të futeshe në Elbasan nga Qafë-Kërraba, kishe dy pamje të identifikimit të Elbasanit: e gjithë krahura e ish-Metalurgikut e trishtë dhe tymi pa fund i djegies së plehrave pranë varrezave të Elbasanit.

Ne, si qeveri, këtë qasje e bëmë me kurajë dhe me një program, i cili po jep efektet e korrigjimit të këtij imazhi. Unë nuk dua të heq paralele të karakterit popullor, por është njësoj si të ndërtosh një vilë dhe të mos ndërtosh tualet. Kështu ishte katandisur Shqipëria në qasjen ndaj plehrave.

Ne kemi filluar të korrigojmë dhe të japim një impakt të jashtëzakonshëm me tri modelet që po bëhen, pavarësisht hetimit që ka nisur, që bëhet brenda kompetencave që kemi ne dhe organet përkatëse të merren me elementet, për të cilat ju e kërkuat ngritjen e një komisionit, por unë si ish-kryetar bashkie jap edhe shembuj të vizitave studimore që kemi bërë për trajtimin e mbetjeve në Europë. Në vitin 2009 kemi qenë në Holandë, ku janë 11 inceneratorë; inceneratori i Nijmegenit ishte ndërtuar me 230 milionë dollarë, inceneratori i Roterdamit me 290 milionë dollarë, ndërkohë që një familje holandeze paguan 230-260 dollarë në vit dhe këtë pagesë e bëjmë për familje, që shkojnë drejt filozofisë që, sa më shumë mbetje të ketë, aq më shumë taksa ka. Bota sot ka një filozofi “pasurohu duke prodhuar sa më pak mbetje; mos u dhuro mbetje të tjerëve”. Pra, kemi për detyrë të kryejmë një detyrë, por kemi për detyrë të japim edhe sinjale sensibilizuese për edukimin e publikut dhe për qasja që duhet të kemi ndaj këtij shërbimi.

Kur isha kryetar bashkie, e subvencionoja pastrimin 45%, se aq taksa paguanin qytetarët, 13 mijë lekë të vjetër në vit dhe aq taksa paguante biznesi. Duhet të kemi qasje të studiuara dhe një platformë kombëtare, jo sipas modelit ndryshe e bën Berati dhe ndryshe e bën Fieri studimin e kostove të pastrimit.

Qeveria, veç masave për t’i dhënë fund trashëgimisë negative të trajtimit të mbetjeve, ka shpallur edhe një projekt, pikërisht për këtë çështje: për një Shqipëri të pastër që të unifikohen shërbimet dhe kjo çështje të bjerë në dorë ligjore, sepse kompetente nuk nga nderon. Prandaj,

edhe kostot që shtohen këtu, pa dyshim do të ketë kosto, sepse janë të përlogaritura në bazë të shërbimeve që bëhen dhe produkteve që duhet të largohen.

Nuk dua të zgjatem shumë duke dhënë mesazhe, por e mora fjalën pikërisht për të thënë se modelet qarkullojnë në të gjithë Europën. Ne tani nuk mund të shkojmë atje tek inceneratori i Elbasanit dhe të themi ku është energjia dhe sa energji prodhohet, se ai nuk është as termocentral, as hidrocentral, por si produkt përpunues nxjerr edhe energji, nxjerr edhe avull, nxjerr edhe hi dhe nxjerr edhe gjëra të tjera. Qëllimi është asgjësimi i plehrave dhe trajtimi i tyre me standarde bashkëkohore. Për të gjitha procedurat e tjera, që ju i ngrini këtu, silli dokumente e të tjera me radhë, unë jam i hapur dhe bashkëpunues që institucionet përkatëse ligjore të merren përkatësisht me këtë. Ne kemi mbrojtjen apo argumentimin e gjithë skemës, me të cilën është futur një program trajtimi dhe një zgjidhje kanceroze e këtij fenomeni në Shqipëri.

Faleminderit!

Helidon Bushati – Po e vazhdoj aty ku e mbaroi parafolësi, te prezumimi i heqjes së kancerit, që ka qenë ndotja. Unë mund të them që vazhdon të jetë, por heqja e një kanceri apo pseudoveprimi, që bëhet për të hequr një të keqe, nuk duhet të bëjë që të implementohet një kancer tjetër, siç është ai i abuzimit. Nuk duhet që diskursi këtu sot i pseudopëmirësimit të performancës të pastrimit të shërbejë si mburojë për abuzimin, me të cilin është kryer.

Ne jemi komision hetimor, i cili një ndër objektivat kryesorë ka analizimin e ndërhyrjes abuzive të institucioneve shtetërore.

Të marrim të mirëqenë që deshëm të fillonim të bënim trajtimin e mbetjeve, sepse nuk ka filluar akoma nëpërmjet incenerimit.

Kryeministri ynë i dashur, pa dyshim më i dashur për ju, shkon e gjen Emaarin për të ndërtuar portin e Durrësit, shkon e gjen *Air Albania*, shkon ai vetë dhe i bën ofertë palës turke, gjen investitorë për t'i dhënë koncesionet e shëndetësisë. Domethënë, është një person, që është shumë i involvuar, sidomos kur jepen koncesione, dhe shkon vetë, bën udhëtime pas udhëtimesh për të gjetur subjektet. Sikur të kishte këtë vullnet të mirë dhe sikur të gjente një nga ata investitorët që kanë ndërtuar inceneratorin, që ka parë edhe zoti Nasufi në Roterdam, do të kishim qenë mbase në një diskutim tjetër, ose nuk do të kishte qenë nevoja e këtij komisioni, por shkon e gjen një subjekt të sapokrijuar, pa asnjë eksperiencë në këtë fushë. Si e shpjegoni ju?! Jo vetëm që e gjen, por i shtyn të gjitha ministrinë për të dhënë mendimin e tyre, për të dhënë miratimin e tyre. Edhe një rast që ndodhi, një ministër konservator, ish-ministër i Financave, si

Cani, u detyrua brenda pak ditësh të ndryshonte mendim. U largua zonja Denaj. Do të doja t'u bëja një pyetje si zonjës Denaj, si zonjës Felaj; kanë qenë ministre. A keni pasur në eksperiencën tuaj qoftë edhe një rast ku të jenë dhënë për të njëjtën procedurë 14 miratime nga 14 institucione të ndryshme brenda ditës?

Ju, zonja Felaj, thatë këtu se nuk ka asgjë të keqe për të dhënë një miratim brenda ditës. Është e pamundur kur bëhet fjalë për një koncesion. Asnjëherë nuk ka ndodhur që të jepet një miratim brenda ditës për një koncesion, qoftë edhe nga një institucion i vetëm, jo 14 miratime brenda ditës për një koncesion. Kjo është e turpshme. Po çfarë tregon nga ana tjetër?! Kjo tregon koordinim dhe kush mund t'i koordinojë 14 institucione (14 institucione, ministri dhe institucione të pavarura)?! Vetëm një entitet sipëror dhe ky entitet është Kryeministri, sepse asnjë tjetër nuk mund ta koordinojë këtë lloj performance pseudoeficiente të institucioneve, aq më tepër për të marrë miratime nga këto institucione.

Prandaj, është roli koordinues i Kryeministrit që ka bërë të mundur ecjen përpara të këtij kanceri që po kap financat shqiptare, sepse ky kancer është duke gërryer financat shqiptare.

Nuk është aspak e vërtetë që ka pasur një përmirësim të eficiencës. Në takimet, që kemi bërë me ministren e Mjedisit, është treguar qartë që edhe sot e kësaj dite edhe në Tiranë plehurat vazhdojnë të jenë i njëjti problem, siç kanë qenë më përpara.

Edhe një performancë që deshën, një eksperiment që deshën të bënin me një shoqëri italiane, pra për selektimin e mbetjeve pati një dështim me sukses të plotë. Prandaj ajo që ju deklaroni, apo ajo që ju po mundoheni të fokusoni vëmendjen e publikut në një pseudopërmirësim të performancës në fushën e mbetjeve është pa dyshim një gënjeshtër e madhe.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë,

Unë do t'ia jap fjalën zotit Etjen Xhafaj, por për procedurë po them vetëm dy gjëra.

Së pari, avokatia që i është bërë inceneratorit të Tiranës nga ana e maxhorancës ka qenë më e dobëta. Unë nuk e di se çfarë keni me Erion Veliajn. Pse nuk e mbrojtët, siç mbrojtët Fierin dhe Elbasanit? Nuk e di çfarë keni me Arben Ahmetajn.

Edhe një herë, unë besoj shumë në integritetin e zonjës Felaj, si ish-ministre, si ish-hetuese, prokurore, si Zëvendëskryetare e Kuvendit, si juriste dhe nuk di se cilës t'i besoj, zonjës Felaj që thotë: “Nuk ka kompani, nuk ekziston, e kam gugëlluar, jam kundër” apo kësaj

avokaturës këtu. Unë prandaj e solla këtë shkresë këtu dhe kisha shpresuar që, bazuar në Kodin e Sjelljes së Deputetit, nenin 13, pikat 1 dhe 2, për konfliktin e interesit, kur një deputet ka një konflikt interesi, është përfshirë në vendimmarrje, është subjekt i një interesi privat, që mund të ndikojë në kryerjen e detyrave të saj siç duhet, konsiderohet konflikt interesi, ashtu siç deputeti ndodhet në një situatë dhe konflikt interesi, duhej ta deklaronte këtë qysh në fillim të kësaj seance.

Duhet shumë, shumë, shumë kurajë ta kundërshtosh, pastaj të vish dhe ta mbrosh këtu.

Zoti Xhafaj që ta përfundojmë.

Etjen Xhafaj – Në fakt, duhet edhe pak kurajë që të pranosh se konflikti i interesit është edhe kur është menduar një mënyrë tjetër e menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve të kryeqytetit dhe, sigurisht, ka një konflikt interesi me atë që është vendosur nga qeveria. Megjithatë, unë nuk dua të ndaloj tek emrat personalë të askujt, sepse besoj se përgjegjësimi, sidomos kur kemi një objekt shumë të qartë qoftë të komisionit hetimor, qoftë të asaj që duhet të bëjmë ne të gjithë, dhe kur unë besoj që të dyja palët, pavarësisht se jemi ulur përballë në këtë tavolinë, kemi një qëllim të përbashkët, është që: rezultat i këtij komisioni të evitohet çdolloj rasti apo mundësi për korrupsion në të ardhmen. Sigurisht, ky është një nga prioritetet e qeverisë dhe të gjithëve ne si ligjvënës dhe fakti që ne kemi raste që i përmendim, në fakt, tregon se ka një luftë kundër korrupsionit dhe fakti se tek e gjitha kjo procedurë, te çdo diskutim, që ne po bëjmë, mund të paragjykojmë vendimmarrjen në një ditë, por nuk paragjykojmë dot procesin, se procesi ka ndodhur. Dokumentet, që janë sjellë në këtë komision nga institucionet e ndryshme, duke filluar nga Ministria e Mjedisit te Ministria e Financave, sigurisht tek autoritetet kontraktore, kanë treguar që, në fakt, ka pasur një diskutim gjatë gjithë kësaj kohe. Paragjykimi i efektit, pra i vendimmarrjes në një ditë, nuk mohon të gjithë pjesën tjetër dhe, në qoftë se do të duhet të shikojmë atë, hajdeni të shikojmë atë, por duhet të kemi parasysh që është miratimi i një procesi, jo mosndodhja e atij procesi, sepse këtu po paragjykojmë bazuar mbi atë që duam ne të jetë rezultati.

Unë besoj se ne do të duam të gjithë që rezultati të jetë, që, në qoftë se ka pasur problematika, mundësi korrupsioni në këtë proces, të mos ndodhin më dhe ne, si ligjvënës, të votuar për të qenë këtu, të marrim masa që kjo të mos ndodhë. Hapat kohorë dhe institucionalë nuk kanë ndodhur vetëm atë ditë, pavarësisht se si thuhet këtu.

Fakti që sot kemi indicie për një debat mes institucioneve qoftë për një shkresë të ministrit të Financave apo të ministrit të Shtetit në këtë rast, do të thotë se ka pasur një debat dhe një diskutim mes institucioneve. Partia, që ju përfaqësoni këtu, nuk ka pasur të tilla në 15 vjet qeverisjeje. Ky nuk është një shembull i mirë që me demokraci ju i keni bërë në rregull ato, sepse nuk ka pasur asnjë indicie apo kundërshtim publik as për piramidën nga krahu juaj, por ndodhën dhe të gjithë e dimë atë histori.

Pra, në fund të ditës nga të gjitha dokumentet që janë sjellë, po shikojmë që ka pasur një proces ndërinstitucional, ku ka pasur një debat dhe një diskutim ku ca gjëra janë pranuar, ca gjëra janë kthyer, ca gjëra nuk janë pranuar. Në qoftë se do të kapemi pastaj me zgjidhjet, ne e dimë të gjithë dhe e pamë në vitin 2015 gjatë përmblyjeve, ju kujtohet që u bë problem bilateral me Kroacinë historia e mbetjeve tona që hidhen nëpër lumenj, se u përmblyt Shqipëria dhe dolën në veri të Kroacisë, se kështu është cikli i ujërave. Pra, të gjithë e dimë që, si pasojë e kundërshtisë të gjithanshme me çfarëdolloj regjimi që kishim përpara, kemi pasur një emergjencë që, sigurisht, e kemi ende sot, sepse ka 31 vjet që ky problem nuk menaxhohet në shumë anë të Shqipërisë.

Në qoftë se zgjidhja e preferuar apo e vendosur nuk do të ishte incenerimi, ky është tjetër parim. Ne këtu jemi për të parë një procedurë dhe për t'u siguruar që ajo procedurë, në qoftë se do të ribëhet më çfarëdolloj procedure të këtij lloji, të mos ketë asnjë shkelje. Pra, vendimi për të inceneruar plehrat apo jo është një vendim që është marrë bazuar mbi ato që kanë qenë këshillimet e qeverisë në atë moment, sigurisht, edhe të kostove.

Në qoftë se do të diskutojmë kostot pastaj, hajdeni të bëjmë krahasimin, se ky diskutimi nëse janë shumë apo pak nuk mund të bëhet si i tillë, por duhet diskutuar nëse vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, kryeqytetet, a kanë këtë kosto apo jo, sepse nuk duhet të harrojmë në asnjë moment që urbanizimi i menjëhershëm, sidomos i bërë nën premisat e mosmenaxhimit të mbetjeve, qoftë edhe atyre të prodhuara nga proceset e ndërtimit, qoftë edhe atyre të prodhuara nga familjet ka një kosto të jashtëzakonshme, e cila nuk zgjidhet me një plumb të argjendit apo me një të rënë të lapsit.

Unë do të doja shumë që, kur t'u referoheshim raporteve edhe të institucioneve kushtetuese si KLSH-ja, të kemi parasysh se ka edhe një konflikt interesi këtu me ca nga njerëzit e nderuar, që janë në përbërje të këtij komisioni për vendime apo vendimmarrje të KLSH-së. Nëse do të flasim për afatet kohore, ne jemi të gjithë koshientë se çfarë ka ndodhur në tre vjetët e

fundit. Nuk mund ta paragjykojmë në asnjë moment produktin final; sigurisht mund të ketë shkelje përgjatë rrugës dhe hajdeni të ulemi të gjithë t'i gjejmë e t'i përcaktojmë.

Megjithatë, duke iu referuar asaj që tha kolegu më parë, fakti që ne sot arrijmë të vlerësojmë njërën pjesë të gjërave, pra *Air Albania* apo *Emaar-in*, udhëtimet dhe kohën, po, në fakt, kjo është një nga detyrat primare të çdo qeverie. Edhe ju në kohën tuaj e keni bërë, pavarësisht se nuk vinte njeri, pavarësisht se tre vjetët e fundit shkohej vetëm në vende që mbarojnë me “stan” në fund.

(Diskutime në sallë.)

Në qoftë se jeni kaq të bindur që e keni autoritetin absolut, nuk ka nevojë as të më ndërprisni, se unë nuk ndërpreva njeri, në dijeninë time, kam thënë një llaf deri tani dhe ishte ajo thirrja juaj e zakonshme për etikën, që kërkohet gjithmonë vetëm nga njerëzit që keni përballë, pra bëni si themi ne dhe mos bëni si bëjmë ne. Në fakt, në qoftë se u referohemi raporteve të KLSH-së të kontrolluara nga ju, në kohën tuaj i kemi shumë të qarta situatat, se edhe ne këtu kemi qenë, edhe në opozitë, edhe tani që nuk jemi më në opozitë, por e mbajmë mend shumë mirë se si ishte realiteti qoftë i pjesës së projekteve të mëdha të investimeve publike, qoftë edhe i menaxhimit të mbetjeve.

(Diskutime në sallë.)

Kryetare, unë jua kam thënë disa herë, nëse ju keni problem me të dëgjuarin, ndoshta duhet të flisni më pak ju, nuk ka nevojë të bëni narratorin për të gjithë ne. Ne nuk jemi këtu të zgjedhur nga ju, jemi këtu të zgjedhur nga qytetarët shqiptarë dhe flasim për një audiencë që nuk jeni ju. Në qoftë se e doni kohën për të folur, duhet ta respektoni edhe kur e marrin të tjerët. Në qoftë se nuk arrini ta bëni dot këtë, ndoshta duhet ta ulni pak dramacitetin e të gjitha diskutimeve që bëhen këtu.

Kjo historia e djegies së plehrave e dimë të gjithë se ka ndodhur, e kemi parë të gjithë në qytetet tona. Tani hajde dhe t'i shikojmë faktet!

Është e jashtëzakonshme kjo që kërkohet gjithmonë pjesa e respektit dhe etikës, pastaj lotët e krokodilit për të gjitha historitë janë se sa herë flasim ne nuk duhet të mbarojmë asnjëherë fjalitë. Megjithatë, unë besoj se, në fund të ditës, hajde ta shikojmë objektivisht pjesën procedurale dhe mos të hedhim vetëm slogane nga fillimi në fund.

Nuk po them në asnjë rast se opozita nuk është e justifikuar që të denoncojë, por po them që objekti i këtij komisioni duhet të rrijë aty ku është.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Zonja Felaj, për procedurë.

Ermonela Felaj – Etjen, shumë faleminderit për fjalën, veçse ju nuk ishit për arsye shëndetësore në mbledhjen që ka bërë ky komision hetimor për planin hetimor. Të shkuara!

Kështu që unë dua të sjell në vëmendjen e të gjithëve edhe për Helidonin, që nuk e kuptoj nëse ishit apo nuk ishit, edhe nëse ishit nuk ka problem, por ne kishim bërë një marrëveshje paraprake me kryetaren, që plani i hetimit të zhvillohej kështu, siç është zhvilluar gjatë kësaj jave dhe kjo mbledhje ishte planifikuar të mbaronte në orën 12:00, me qëllim që të mund t'i harmonizojmë të gjitha nevojat e anëtarëve të këtij komisioni dhe ne e vazhdojmë mbledhjen, se nuk ka mbaruar. Kush dëshiron të vijë dhe ka ende diçka për të shprehur, do të jemi në Sharrë dhe aty do të ndiqet e gjitha nga media, kështu që është një mundësi për ta vijuar atje, por qëndrimi akoma këtu, realisht i përmbys planet e të gjithëve dhe e prish mbledhjen. Ne kishim folur për këtë gjë. Tani është ora 13:00, prandaj ta mbyllim e ta vazhdojmë atje.

(Diskutime në sallë.)

Jorida Tabaku – Ju lutem, kërkoj mirëkuptim!

Të nderuar kolegë, sot arritëm të dëgjojmë vetëm procedurat dhe aferën korruptive nga ana e opozitës, fatkeqësisht, nga ana e maxhorancës nuk patëm asnjë informacion. Unë dua të njoftoj komisionin para se të mbyll mbledhjen që, bazuar mbi informacionin, t'i dërgojë një shkresë kryetarit të ERE-s, zotit Petrit Ahmeti, bazuar mbi atë që zonja Felaj sugjeroi herën e kaluar, për të sqaruar çështjen e energjisë me inceneratorin e Elbasanit.

MBYLLET MBLEDHJA